

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7778 E mërkurë 30 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion Ditës

Nga EDMOND ÇATA



**D**eklaratat e pedagogëve të UT konfirmojnë vetëm një gjë: Domosdoshmërinë jetike të rithemelimit të UT! Që studentët e sotëm e të ardhshëm, vetë ...  
Vijon në faqen 20

**Rithemelimi i Universitetit të Tiranës është imperativ!**

## Opinion Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



**N**ë Shqipëri janë në veprim deri tani 217 kontrata koncesionare/PPP (Partneritet Publik-Privat), një numër shqetësues për një vend të vogël si tonin ...  
Vijon në faqen 21

**Shqipëria, "Eldorado" e koncesioneve dhe PPP-ve**



Maqedonia, progresi më i madh në rajon

## Korrupsioni, del raporti: Shqipëria e fundit në Ballkan, zbret me 8 vende


FMN jep alarmin për PPP: Borxhi publik, 260 mln euro më shumë se sa thotë qeveria

Shqipëria ka bërë hapa pas sa i përket perceptimit që kanë qytetarët e saj mbi nivelin e korrupsionit në vend. Raporti i organizatës, "Transparency International", mbi shkallën e korrupsionit në botë për vitin 2018 e ka radhitur Shqipërinë në vendin e 99-të me 36 pikë, ndryshe nga një vit më parë kur ajo ishte radhitur e 91-ta me 38 pikë ...  
Në faqen 2-3

## FORMULARI/ AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE, KOSTOJA E APLIKIMIT ESHTË 2000 LEKË

# TOKAT E ZENA, SI MUND TE PERFITONI KOMPENSIMIN

Pronarët e tokave që u zunë nga ndërtimet pa leje, 7 dokumentet që duhen dorëzuar në ATP. Publikohet kartela informative për çdo aplikant



(Në foto) Formulari i kompesimit

## ISH-SIGURIMSAT

**Gentiana Sula: Dosjet, 30 zyrtarë me probleme. Bujar Sheshi bën padi**

Në faqen 4

## OPOZITA

**Protesta më 16 shkurt, Basha: Do t'i hapë rrugën qeverisë studentore**

Në faqen 6

## SHOWBIZZ

**Nostalgjia, VIP-at publikojnë foto kur kanë qenë fëmijë, ja si duken**

Suplemen

## DURRES

**18 punonjëse të fasonerisë helmohen nga gazi, reagon sindikata: Drejtësi**

Në faqen 18

## INTERVISTA



**E vrau babai dhe e groposi në oborr, halla: Që 13 vjeçe e përdhunuan**

Në faqen 9

Mbledhja e këshillit bashkiak në 31 janar/ Vendimet që pritet të miratohen

## Ndihma ekonomike, 2924 familjet përfituese

Lista e tretë, ja kush do të marrë pagesë nga bashkia

NGA VOLTIZA DURO

**N**ë mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës pritet që të miratohet edhe ndihma ekonomike për 2924 familje në kryeqytet. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e tretë të emrave që priten të marrin



këtë pagesë, pas miratimit në mbledhjen e 31 janarit. Mes këtyre familjeve që do të përfitojnë ndihmën ekonomike, ka dhe persona me statusin e jetimit, viktima të dhunës në familje, individë viktimë të trafikimit apo edhe familjet me shumë fëmijë. "Kanë ...

Në faqen 10-11

# KONCENSIONET VENDIMI

Fondi: Borxhi publik, rreth 260 milionë euro më shumë se raportimi i qeverisë

## FMN jep alarmin për PPP-të, po rrisin rreziqet fiskale

Raporti: Kontratat janë 15% e GDP-së vetëm në 2019-n

Fondi Monetar Ndërko mbëtar jep alarmin se kontratat e Partneritetet Publike Private paraqesin rreziqe fiskale për financat publike. Në staf raportin e fundit për Shqipërinë, ky institucion nënvizon se angazhimi i projekteve infrastrukturore përmes PPP-ve ka rezultuar në rritje detyrimeve potenciale, ndërkohë që kontratat janë të hartuara dobët dhe mund të pengojnë efikasitetin e investimeve publike. Shqetësimi të projektet PPP duket se u referohet shifrave, të cilat kanë pësuar rritje të shpejtë në raport me GDP. "Rritja e shpejtë e PPP ka shtuar edhe risqet fiskale dhe stafi propozoi hapa të mëtejshëm për të kontrolluar këtë aspekt. Përveç stokut ekzistues të PPP-ve prej 31 për qind e GDP-së (që mbulon më shumë se 220 projekte përfshirë koncesionet në energji me më shumë se 23 pikë përqindje) në buxhetin e 2019 dokumentet parashikojnë një listë të PPP-ve potenciale që arrijnë në 15 për qind të GDP-së", thuhet në raport. "Në kahun e brendshëm, borxhi publik është i lartë, ndërsa niveli i ulët i kursimeve të brendshme dhe mungesa e investitorëve të mëdhenj institucionalë e rrit varësinë ndaj burimeve të huaja të financimit. Rritja e varësisë nga PPP-të për projektet e infrastrukturës ka rezultuar në shtimin e detyrimeve potenciale. Rreziqet e brendshme gjithashtu përfshijnë ndikimin e thatësirës në prodhimin e energjisë, duke krijuar risqe për buxhetin", thuhet në raport.

### ANALIZA

Fondi Monetar Ndërko mbëtar në raportin e publikuar djete duket se e rrezon qeverinë shqiptare pasi thotë se, borxhi publik nuk ka zbritur as në 2017 dhe as projektet të ketë rënë në 2018, nën 70% të Prodhitimit të Brendshëm Bruto. Ndërkohë që qeveria projektton se borxhi ka rënë në 69.9% të PBB në 2017, FMN thotë se atë vit, borxhi publik ishte në 71.8% të PBB, pra thajuse 2 pikë përqindje. Kjo përkthehet në rreth 260 milionë euro më shumë. Edhe për vitin që sapo lamë pas, FMN thotë qartë se borxhi publik projektohet të ketë rënë në 70.5% të PBB. Ndërkohë në kushtet kur Shqipëria ende nuk ka ndërprerë vrullin e PPP, Fondi ka rekomanduar që të forcohet dhe konsolidohet vendimarrja lidhur me procesin e



Faksimile e raportit të FMN-së

### FMN gjeti 200 mln euro detyrime të prapambetura deri në shtator 2018

Fondi Monetar Ndërkombëtar referoi se besueshëria e qeverisë shqiptare po cenohet prej rikthimeve të detyrimeve të prapambetura ndaj investimeve publike në infrastrukturë dhe në rimbursimin e TVSH-së. Deklarata u lëshua nga Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar pas miratimit të konsultimeve të stafit teknik, që vlerësoi zhvillimet ekonomike në Shqipëri gjatë shtatorit 2018. Të dhënat nga Washingtoni tregojnë se detyrimet e prapambetura kanë arritur në 24.5 miliardë lekë (200 milionë euro) deri në shtator të vitit 2018. Kjo shumë, që është sa 1.5 për qind e PBB, dominohet nga borxhet e qeverisë qendrore me rreth 17 miliardë lekë dhe nga borxhet e qeverisë lokale me mbi 7 miliardë lekë. Nga borxhet e qeverisë qendrore, 11.3 miliardë lekë janë detyrime për TVSH-në e parimbursueshme dhe 6.1 miliardë lekë detyrime të tjera, kryesisht ndaj investimeve publike në infrastrukturë. Në raport me vitin fundin e vitit 2017, borxhi i fshehur u ul në rreth 300 milionë lekë për TVSH, por u rrit po në këtë masë për detyrimet e infrastrukturës.

investimeve publike në këtë formë duke nënvizuar sigurimin e vlerës së parësë në këto projekte PPP, që do të thotë projektet përmes një procesi ofertimi konkurrues. Një tjetër problematikë e hasur sipas FMN-së është që vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve të investimeve vazhdojnë të jenë të fragmentuara në varësi të burim i financimit të projektit. "FMN mirëprit ndryshimet e planifikuar në legjislacionin e PPP për të rritur rolin e Ministrisë

së Financave dhe Ekonomisë si një mbikëqyrës për koston potenciale të PPP-ve si një hap i parë pozitiv. Do të ishte kritike që të sigurohet vlera e parave përmes një procesi ofertimi konkurrues për të gjitha projektet, duke ndaluar kështu pranimin e ofertave të pakërkuar. Nga ana tjetër, shpenzimet vjetore të qeverisë të lidhura me PPP-të parashikohet që të mbeten nën kufirin ligjor prej 5 për qind. Ky tavan lë shumë pak vend për PPP të tjera të financuara nga

**REAGIMI**  
"FMN përmes raportit të tij të fundit konfirmon gjithashtu atë që Qeveria Shqiptare ka arritur në drejtimin e kësaj detyrimeve të dekadent e fundit" shkruan në reagimin e Ministrisë së Financave.

qeveria veçanërisht duke pasur parasysh nevojën për të inkuorporuar risqet nga detyrimet potenciale. FMN nënvizon gjithashtu rëndësinë për marrjen e masave për të mos krijuar më detyrime të prapambetura, pasi këto dëmtojnë aktivitetin ekonomik dhe minojnë besimin në sektorin publik.

### VENDIME E BSH

Lidhur me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, drejtorët e Bordit të FMN-së e kanë konsideruar atë si të duhurën. Ata konsiderojnë se normalizimi i politikës monetare duhet të jetë në varësi të shifrave, me synimin për të arritur objektivin e inflacionit në afatin e mesëm. Drejtorët e mirëpritën angazhimin e autoriteteve për të mbajtur një regjim kursi këmbimi fleksibël dhe ranë dakord që ndërhyrjet duhet të jenë të përkohshme dhe të kufizuara për të parandaluar kushtet jonormale të tregut dhe një destabilizim të inflacionit. Drejtorët e bordit bënë thirrje për masa më të forta për të adresuar ngërçin e rritjes së kredisë dhe për të përmirësuar efektivitetin e transmetimit të politikës monetare. Ata inkurajuan autoritetet që të përshpejtojnë zbatimin e masave të de-euroizimit dhe të adresojnë dobësitë strukturore në tregun e kredive, përfshirë dhe huat e larta me probleme. Forcimi i të drejtave pronësores dhe zgjidhja e paafetësisë paguese do të jenë të dobishme në këtë drejtim.



Foto ilustruese

### Tabaku: Qeveria s'është tërhequr nga PPP, s'ka nisur kufizimi

Ndryshimet në ligjin për kontratat e Partneritetit Publik Privat dhe anulimin e kontratës për projektin Thumanë-Kashar, Partia Demokratike nuk e sheh si tërheqje të qeverisë nga ky model financiar. Madje, për deputetën e Partisë Demokratike dhe nënkryetaren e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku, qeveria po kujdeset që të përfundojë të gjitha kontratat në proces, duke cenuar në këtë mënyrë edhe konkurrencën. "Unë nuk e konsideroj tërheqje, sepse në qoftë se do të ishte tërheqje, do të anuloheshin të gjitha kontratat. Në qoftë se do të ishte tërheqje, zbatimi do të fillonte në 1 janar të këtij viti. Ndërkohë që ato janë duke u kujdesur që të përfundojnë të gjitha kontratat që janë në proces dhe janë duke u kujdesur që të bëjnë dhe kontrata të reja, siç mund të jetë rasti i autostradës Tiranë-Durrës. Ofertat e pakërkuara kanë cenuar konkurrencën. Ofertat e pakërkuara kanë rritur kostot është e paimagjueshme që një 1 km rrugë të shkojë 20 milionë euro, 22 milionë euro", - tha Tabaku. Teksa këtë model financiar Tabaku e cilëson si eksperiment të rrezikshëm, në një intervistë për "News 24", ajo shprehet se rrezikun më të madh e ka borxhi publik dhe qytetarët. Ajo thotë se kontratat e firmosura deri më tani do të rendojnë në buxhet, pasi kanë kapur vlerën e 3 miliardë dollarëve si borxh i fshehur. "Rreziku aktual që i kanoset buxhetit të shtetit në përgjigjësi, por çdo qytetari në veçanti është rritja e borxhit. Borxhi publik ka shkuar sot në 71%. Kjo 71% e shtuar dhe 13% të projekteve të PPP e çojnë borxhin në shifra të frikshme në 83-84%. Çfarë ndodhi me tërheqjen nga kontrata e rrugës Thumanë-Kashar. Megjithatë është një kontratë që ka angazhime konkrete, nuk llogaritet në borxh. Për vitin aktual ka zero pagesë. PAGESA fillon për vitin e ardhshëm me 20 milionë euro dhe këtu ndalon. E pyetur në lidhje me nismën me të re të qeverisë, atë të krijimit të korporatës së investimeve strategjike, Tabaku është e prerë. E cilëson një projekt korruptiv që do të ndajë prona private dhe publike me procedura të dyshimta. "Korporata e investimeve publike është një projekt korruptiv, i cili ka për qëllim që nëpërmjet procedurave të dyshimta pa garë pa tender të ndajë prona publike dhe private. Ne jemi duke e analizuar si ligji, do ta denoncojmë në të gjitha instancat që kanë lidhje me çështjen e pronës dhe sigurisht që do ta kundërshtojmë. Shpresoj shumë që të tërhiqet, të mos rrezikojë pronën private dhe publike dhe të mos e ndajë atë si plaçkë", - tha Tabaku. Sipas deputetes demokratke, korporata e investimeve strategjike ka lidhje edhe me cenimin e ish-pronarëve të vjetër.





Raporti i TI për perceptimin e korrupsionit e vlerëson Shqipërinë me 36 pikë

# Korrupsioni, Shqipëria mbetet e fundit në Ballkan, zbrit me 8 vende

Progresin më të madh në Ballkan e ka bërë Maqedonia

Shqipëria ka bërë hapa pas sa i përket perceptimit që kanë qytetarët e saj mbi nivelin e korrupsionit në vend. Raporti i organizatës, "Transparency International", mbi shkallën e korrupsionit në botë për vitin 2018 e ka radhitur Shqipërinë në vendin e 99-të me 36 pikë, ndryshe nga një vit më parë kur ajo ishte radhitur e 91-ta me 38 pikë. Në këtë raport Shqipëria ka rezultatin më të keq nga të gjitha shtetet e Ballkanit, duke mbetur në fund të tabelës teksa sheh para saj tashmë Maqedoninë apo Kosovën. Raporti që përfshin 180 vende të botës përdor një shkallë prej zero pikësh deri në 100, ku zero tregon për një vend shumë të korruptuar. "Duke qenë vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Shqipëria ishte përmirësuar gjatë pesë viteve të fundit me pesë pikë. Por, krahasuar me një vit më parë ajo ka shënuar rënie për dy pikë, nga 38 në 36 në krahasim me vitin e kaluar. Kjo mund të jetë për shkak të një ngërçi politik që bllokoj disa reforma antikorruptive të ecin përpara. Me një proces të ri të vetingut dhe kuadrin institucional të kundër korrupsionit pothuajse të plotë, mbetet për t'u parë nëse Shqipëria do të përmirësojë rezultatin e saj në të ardhmen", - thuhet në raport. Në raportin e përgjithshëm prej 180 vendesh, Shqipëria e shëh veten e saj mes vendeve të tilla si Mongolia dhe Panama-ja, që renditen para saj dhe Bahrenit, që renditet në vend të 100. Regres ka bërë në këtë raport edhe Kosova, e cila nga 39 pikë që kishte një vit më parë, është vlerësuar me 37 pikë, duke u renditur në vend të parafundit sa u përket vendeve ballkanike. "Disa nga sfidat më të mëdha të kundër korrupsionit në Kosovë përfshijnë transparencën e pamjaftueshme, institucionet e dobëta e sundim të dobët të ligjit dhe hapësirë të pamjaftueshme për angazhimin e qytetarëve. Për të trajtuar këto çështje, Instituti Demokratik i Kosovës mbikëqyr institucionet publike, nxit transparencën e financimit të partive politike dhe kryen fushata të ndryshme për të angazhuar qytetarët në vendimarrje", - theksohet në raport. Një hap pozitiv përpara ka bërë Maqedonia, e cila duket se po përjeton një periudhë të artë si në proceset integruese,



Foto ilustruese

## RENDITJA E VENDEVE TË BALLKANIT

36. Sllovenia	60 pikë
60. Kroacia	48 pikë
61. Rumania	47 pikë
66. Greqia	45 pikë
67. Mali i Zi	45 pikë
77. Bullgaria	42 pikë
87. Serbia	39 pikë
89. Bosnje-Hercegovina	39 pikë
93. Maqedonia	37 pikë
94. Kosova	37 pikë
99. Shqipëria	36 pikë

## VLERËSIMI

Në vlerësimin e organizatës thuhet se Evropa Lindore dhe Azia Qendrore janë rajoni i dytë për radhitjen më të keqe, pas Afrikës. Fakti që pothuajse të gjitha vendet kanë 45 e më pak pikë nga 100 syresh tregon se është shënuar përparim i paktë në luftimin e korrupsionit.

ashtu edhe në zgjidhjen e ngërçit historik me Greqinë. Ajo ka rikuperuar 2 pikë në krahasim me një vit më parë teksa është vlerësuar me 37 pikë. Sa u përket vendeve ballkanike, vendin e parë e mban Sllovenia me 60 pikë, e nd-

jekur nga Kroacia me 48 pikë dhe për të vazhduar me Rumaninë me 47 pikë, Greqinë dhe Malin e Zi me 45 pikë, Bullgarinë 42 pikë, Serbinë dhe Bosnjën me 39 pikë. Në vlerësimin e organizatës thuhet se Evropa Lindore dhe

Azia Qendrore janë rajoni i dytë për radhitjen më të keqe, pas Afrikës. Fakti që pothuajse të gjitha vendet kanë 45 e më pak pikë nga 100 syresh, tregon se është shënuar përparim i paktë në luftimin e korrupsionit.



## Danimarka dhe Zelanda e Re, vendet me më pak korrupsion në botë

Danimarka është vendi më pak i korruptuar në të gjithë botën. Ky është perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin në këtë vend, i pasqyruar në raportin e "Transparency International", që u bë publik dje. Sipas këtij raporti, Danimarka ka mundur të rimarrë vendin e parë, të cilin vitin e shkuar e mbante Zelanda e Re. Danimarka është vlerësuar me 88 pikë nga 100 të mundshmet, ndonëse në raport me 3 vite më parë ka pasur një rënie të ndjeshme. Pas saj në renditje është Zelanda e Re me 87 pikë dhe pas saj vijnë Finlanda, Singapori, Zvicra dhe Suedia me 85 pikë. Gjermania renditet në vend të 11 me 80 pikë, po aq sa edhe Mbretëria e Bashkuar që mban vendin e 11. Ndërkohë që SHBA mban vendin e 22 me 71 pikë, ndërsa Kina mban vendin e 87 me 39 pikë dhe Rusia renditet e 138 me vetëm 28 pikë.

## VENDET ME MË PAK KORRUPSION

1. Danimarka 88 pikë
2. Zelanda e Re 87 pikë
3. Suedia 85 pikë
4. Zvicra 85 pikë
5. Singapori 85 pikë
6. Finlanda 85 pikë
7. Norvegjia 84 pikë
8. Holanda 82 pikë
9. Kanadaja 81 pikë
10. Luksemburgu 81 pikë
11. Gjermania 80 pikë
12. Mbretëria e Bashkuar 80 pikë
13. Australia 77 pikë
14. Austria 76 pikë
15. Hong-Kong 76 pikë
16. Islanda 76 pikë
17. Belgjika 75 pikë

## Somalia dhe Siria, vendet më të korruptuara

Vendet më të korruptuara në botë vijojnë të mbeten ato afrikane, aziatike dhe të Amerikës Latine. Edhe në raportin e 2018-ës, një sërë vendesh të Afrikës mbyllin renditjen si vendet më të korruptuara në botë. Në vend të fundit renditet Somalia, e cila ka vetëm 10 pikë nga 100 të mundshme. Pas saj vjen Siria, një vend në luftë, e cila është vlerësuar me 13 pikë, po aq sa ka dhe Sudani, gjithashtu një vend në konflikt të ar-



mator. Në vend të katërt nga fundi, si një vend me korrupsion të lartë renditet edhe shteti komunist i Ko-

## KUPA

175. Jemen 14 pikë
176. Koreja e Veriut 14 pikë
178. Sudani 13 pikë
178. Siria 13 pikë
180. Somalia 10 pikë

resë së Veriut me 14 pikë, po aq sa ka edhe Jemeni që renditet në vend të pestë nga fundi.

**Njoftim për shitje me ankand te trete**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenet 577, 568 të K.Pr.Civile ka shpallur ne date 21.01.2019 shifjen me ankand te trete të pasurisë palës debitoro, hipotekeuse dhe palës dorëzënëse.

- "Tokë Ate" në Z.K 1987 me numër pasurie 30/38 Volumi 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 Lezhe me çmim filltar prej 52.214.4 Euro
- "Tokë Ate" në Z.K 1987 me numër pasurie 40/56 Volumi 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 Lezhe me çmim filltar prej 90.331.2 Euro
- "Tokë Ate" në Z.K 1987 me numër pasurie 25/73 Volumi 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m2 Lezhe me çmim filltar prej 88.301.8 Euro

Akandit qendror i hapur për 30 ditë dhe do të zhvillohet në datën 20.02.2019 në orën 15:00, në sallën tona Bulev "Ç. Fisha" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5 kontakte 0672082453 ose email [dir\\_dorizshaj@yahoo.com](mailto:dir_dorizshaj@yahoo.com) dhe ne WEB [www.powerjustice.al.com](http://www.powerjustice.al.com)

**DOSJET**  
**DEBATI**

Autoriteti i Dosjeve ka konfirmuar dje saktësinë e klasifikimit si bashkëpunëtor

# Bujar Sheshi kallëzon AIDSSH, Sula: Vendimi i ynë është i drejtë

*Sula bëri të ditur se 30 zyrtarë kanë rezultuar me dosje*

**A**nëntari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Bujar Sheshi ka kallëzuar Autoritetin e Dosjeve në Prokurori për "falshfikim të dokumenteve" dhe dëmtim të imazhit të tij. Në këtë mënyrë Sheshi hedh poshtë vendimin e këtij autoriteti me anë të cilit ai u konsideruar se ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Ndërsa në padinë e tij citon të gjithë anëtarët e këtij autoriteti duke filluar nga kryetarja, Genta Sula. Bujar Sheshi në padinë e tij thekson se "marrja e këtij vendimi kaq haptazi të padrejtë cenon rëndë integritetin tim moral dhe profesional dhe, gjithashtu, dëmton rëndë interesat e shoqërisë shqiptare, sepse vjen si një presion apo shantazh i hapur mbi punën e anëtarëve të një nga Institucioneve më të Rëndësishme të Reformës në Drejtësi, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në këtë moment historik". Por ndryshe nga sa pretendon prokurori Sheshi në këtë padi dhe në deklaratat e tij edhe publike, Autoriteti i Dosjeve ka konfirmuar dhe një dje vërtetësinë dhe saktësinë e vendimit për ta klasifikuar atë si i tërhequr në bashkëpunim nga ish-Sigurimi i Shtetit në moshtë të mitur. Drejtuesja e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, Genta Sula, tha dje se verifikimet dhe vendimi ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Bujar Sheshi, janë të sakta dhe të bazuara në dokumente, që provojnë lidhjet e tij me Sigurimin e Shtetit. "Bëhet fjalë për një person, i cili nuk mund të jetë pjesë e institucioneve të drejtësisë së demokracisë për shkak të bashkëpunimit të tij me Sigurimin e Shtetit gjatë diktaturës. Por është e drejta e tij të ankohet në prokurori" - tha Genta Sula. Ajo shprehu keqardhjen që vendimi i Autoritetit të publikua nga burime të tjera në kundërshtim me ligjet e konfidencialitetit, por institucioni i saj është i bindur në saktësinë e vendimit. Gjithashtu, Sula hodhi poshtë si të pavërteta pretendimet e tij për prapamendime politike në veprim-



Kryetarja Genta Sula dhe ambasadorja gjermane Suzan Schütz

**DEKLARATA**

"Bëhet fjalë për një person, i cili nuk mund të jetë pjesë e institucioneve të drejtësisë së demokracisë për shkak të bashkëpunimit të tij me Sigurimin e Shtetit gjatë diktaturës. Por është e drejta e tij të ankohet në prokurori" - tha Genta Sula

## Raporti, Braçe nga PS dhe Tabaku nga PD deputetët më aktivë në Kuvend

**A**shtu si edhe në sesionin që sapo u mbyll, pra atë të periudhës shtator-dhjetor nuk ka ndryshuar renditja e deputetëve më aktivë të parlamentit. Sipas raportit të Institutit të Studimeve Politike gjatë sesionit të vjeshtës 2018 në klasifikimin e deputetëve sipas nivelit të efikasitetit në aktivitetin parlamentar rezultoi se deputetët Erion Braçe dhe Vasilika Hysi (PS), Jorida Tabaku dhe Oerd Bylykbashki (PD), si dhe Kejdi Mehmetaj e Luan Rama (LSI) ishin deputetët më aktivë në tri grupet më të mëdha parlamentare. Bojkoti i pjesshëm i opozitës dëmtoi procesin e vlerësimit të deputetëve, por edhe dobësi fuqinë e deputetëve për të ushtruar të gjitha përgjegjësitë parlamentare. Në tërësi gratë deputete ishin 10% më



shumë efektive sesa deputetët meshkuj, gratë ishin dominuese edhe në angazhimin në seancat plenare. Deputetët politikanë të karrrierës patën angazhim dhe efektivitet më të lartë sesa prurjet e reja, dhe se niveli i angazhimit të deputetëve që vijnë nga biznesi ishte në kuotat më të ulta. Deputetët më aktivë ishin ata të qarkut Fier dhe Elbasan,

deputetët më pak efikas ishin ata të qarqeve Shkodër e Lezhë. Në votimet e akteve shumica absolute e mazhorancës shënoi 100% vota pro, ministrat më të akuzuar nga opozita patën minutazhin më të lartë të fjalimeve, dhe se tre deputetë u penalizuan për shkelje të Rregullores së Kuvendit. Gjatë këtij sesioni u miratuan vetëm 3 ligje të reja, në krahasim me 27 ligje në të njëjtë periudhë më 2016 dhe 7 ligje më 2017. Fokusi kryesor ishin ndërhyrje përmirësuese në ligjet ekzistuese ose nisma për ndryshime ligjore në funksion të agjendës politike të ditës. Ky sesion pati 11 nisma ligjvënese nga deputetët, shifër më e lartë sesa sesionet e mëparshme parlamentare, por burimi kryesor i nismave vijon të jetë qeveria.

tarinë e institucionit, i cili ka verifikuar deri tani mbi 1 mijë e 500 persona, vetëm 5 prej tyre janë ankuar dhe vetëm për njërin vendim është tërhequr pas. "Punën e kemi të pandikuar nga çdo gjë që ndodh. I shërbejmë vetëm ligjit. Jemi të hapur për çdo hetim, procesi ka qenë i drejtë dhe janë marrë të gjithë ma-

sat", - tha Sula. Ndërkohë ajo bëri të ditur se deri më tani ky autoritet ka verifikuar figurën e rreth 1500 personave, nga të cilët rreth 300 prej tyre kanë pasur probleme. "Në 1500 personat rezultoi rreth 30 janë gjetur me probleme në sektorë shumë të rëndësishëm. Autoriteti në dy vite ekzistencë ka verifikuar të paktën

1500 figura, të cilët janë të gjithë zyrtarë shumë të lartë. Për organet e larta të drejtësisë kemi verifikuar rreth 550 figura dhe 4 prej tyre janë gjetur me probleme. Në asnjë rast nuk ka axhendë politike tek ne, nuk ka asnjë axhendë, kordinim, absolutisht asgjë. Tek ne është vetëm ligji, procesi" - tha Sula.



Këshilli i Lartë i Prokurorisë

## Dvorani tërheq kandidaturën për anëtar të Gjykatës Kushtetuese

**A**nëntari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ardian Dvorani i Gjykatës Kushtetuese. Anëtar i Gjykatës së Lartë, i cili është vënë në qendër të akuzave nga Partia Demokratike, e bëri të ditur vendimarrjen e tij gjatë mbledhjes së djeshme të Këshillit të Emërimeve të Drejtësi. Dhe duket se arsyeja e këtij vendimi nga ana e tij lidhet pikërisht me faktin se ai u zgjodh anëtar i KED pak muaj më parë, ndërkohë që aplikimin për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese e kishte bërë gati dy vite më parë. Gjyqtari i Lartë sqaron se më 7 dhjetor 2018, është përzgjedhur nga shorti si anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe njëkohësisht kryetar i këtij institucioni për 2019. Në këto kushte, kur KED ka detyrimin ligjor, për të renditur kandidatët për gjykatën Kushtetuese, Dvorani thotë se tërhiqet për të shmangur konfliktin e interesit. Ndërkohë që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), zhvilloi dje mbledhjen e tij të radhës, ku në rëndin e ditës ishte diskutimi dhe miratimi i projektregullores së Brendshme, për organizimin dhe funksionimin e KED-së.



## Spiropali: S'ka më protestë studentësh, por karikaturë të opozitës

**N**donëse një pjesë e fakulteteve vijnë në mos bëjnë mësim, qeveria nuk e njeh më protestën e studentëve. Në një deklaratë për mediat dje, zëdhënësja e qeverisë, Elisa Spiropali deklaroi se tani nuk ka më një protestë të studentëve. "Për fatin më të keq, tanimë nuk kemi të bëjmë me një protestë të studentëve. Ajo që ishte protesta e studentëve i hapu rrugë Paktit për Universitetin dhe një transformimi të vërtetë të jetës universitare dhe cilësisë së arsimit në vend", - tha Spiropali. Ajo theksoi se protesta që vijon në disa fakultete është protestë e përfaqësuesve të partive politike, PD dhe LSI. "Ajo që ka mbetur nga protesta është një karikaturë e protestës, me angazhimin e drejtpërdrejtë të Partisë Demokratike, LSI-së dhe vetë Sali Berishës, i cili është i angazhuar me gjithësej, së bashku me disa segmente brenda universitetit, të vloga, ama të ushqyera ndër vite me tituj të pamerituar dhe me punësim ta paturpshëm pikërisht aty ku ata kanë rrjetet e tyre të njohura nepotike, militante dhe klanore", - theksoi Spiropali.



Kallëzimi ndaj kryeprokurores për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës"

# Dosja "Sheshi", PD-LSI: Të pezullohet Marku, shkeli ligjin

"Nuk e priti përgjigjen e Autoritetit të Dosjeve"

Valentina Madani

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim paditën dje kryeprokuroren Arta Marku lidhur me rastin e ish-prokurorit Bujar Sheshi. PD dhe LSI kanë paditur në Prokurorinë e Tiranës, prokuroren e përgjithshme të përkohshme, Arta Marku për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" për çështjen e prokurorit Bujar Sheshi. Në kallëzimin penal të dorëzuar në Gjykatën e shkallës së parë në Tiranë, dy krerët e grupeve parlamentare Edmond Spaho dhe Petrit Vasili akuzojnë Markun për shpërdorim detyre dhe kërkojnë pezullimin e saj nga detyra. Në kërkesën e tyre drejtuar prokurorisë, PD dhe LSI kërkojnë regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj Arta Markut për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorim i detyrës", të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin më të saktë e më të plotë të rrethanave të parashtruara. Në mbështetje të neneve 240-243 të Kodit të Procedurës Penale, dy kryetarët e grupeve parlamentare PD dhe LSI bëjnë paraqitjen e kërkesës për marrjen e masës ndaluese "pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" apo "ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale", për personat e kallëzuar në këtë kallëzim penal, të cilët nëse vijnë punën, mund të prishin provat apo pengojnë hetimin. Prokurori i përgjithshëm Arta Marku, nuk e priti përgjigjen e Autoritetit edhe pse ishte e detyruar ta priste, me qëllim verifikimin e përbashkët të PD-LSI. Dy partitë opozitare vënë në dukje se: "Bujar Sheshi ishte kandidaturë e vetme nga Prokuroritë e Apelit për Tiranën (e Krimeve të Rënda



**PEZULLIMI**  
"Në këtë rast, pezullimi nga detyra është parakusht edhe për një hetim të pavarur dhe të paanshëm, duke qenë se e kallëzuara është në funksionin e drejtuesit më të lartë të organit të prokurorisë", shprehet PD-LSI.

**"SHESHI"**

Kallëzimi i PD-LSI vjen pasi publikimit të faktit që Bujar Sheshi u zgjodh anëtar i KLP nga Marku. Ai akuzohet se ka qenë i rekrutuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para '90. Sheshi ka mohuar akuzat dhe ka ngritur padi në prokurori kundër Autoritetit për Informim mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit. Autoriteti ka gjetur dokumente, sipas të cilit, Sheshi ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit, me pseudonimin "Venusi".

ture (genia ose jo bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit)", thuhet në padinë e përbashkët PD-LSI. Dy partitë opozitare vënë në dukje se: "Bujar Sheshi ishte kandidaturë e vetme nga Prokuroritë e Apelit për Tiranën (e Krimeve të Rënda

saktësisht) dhe u shpall fitues në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve të datës 11 dhjetor 2018, po u votuar fare. Praktikisht, Bujar Sheshi u caktua në KLP, pasi procesit zgjedhor i mungoi gara, duke mos pasur asnjë kan-

didat përballë. Fleta e votimit i përmbante vetëm emrin e tij dhe nuk kishte as alternativat "pro" dhe "kundër". PD-LSI deklaron se: "Nga të gjitha rrethanat e parashtruara më lart, rezultoni se prokurori Arta Marku, ka shkelur rëndë ligjin, duke mospërbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 279 pika 3 e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Duke vlerësuar se ndërmarrja e veprimeve të tilla me dashje direkte dhe në shkelje të Kushtetutës e të ligjit, Arta Marku ka ndërmarrë veprime në dëm jo vetëm të ligjshmërisë së përbërjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por edhe në dëm të vet interesave të ligjshme të shtetit, për shkak se në këtë mënyrë cenohet besimi i publikut tek organi i prokurorisë. Për pasojë, e kallëzuara nga ana jonë ka konsumuar tërësisht elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal". Sipas PD dhe LSI: "Duke mospërbushur përgjegjësitë sipas ligjit, Arta Marku ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës dhe që cenon interesat e ligjshme të shtetit, me qëllimin kriminal të kontrollit të organit qeverisës së prokurorisë. Për pasojë, Arta Marku ka konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

**SHKELJA**

"Subjekti i veprës penale është subjekti i posaçëm dhe konkretisht prokurorë, e cila me veprimet e saj, ka kualifikuar kandidatit në kundërshtim me ligjin, duke cenuar funksionin normal të KLP. Nga ana subjektive vepra penale është kryer me dashje direkte dhe me qëllimin e posaçëm, ndikimin e paligjshëm në përzgjedhjen e anëtarëve të KLP", thuhet në padinë e PD-LSI.



## PS rrëzon kandidaturën e Metës për KLSH: Shaqiri nuk plotëson kriteret kushtetuese

Kandidati i propozuar prej presidentit në krye të KLSH-së, Bahri Shaqiri, paraqiti në Komisionin e Ekonomisë strategjinë e tij në auditimin e financave të shtetit. Ish-kreu i SHISH vuri theksin tek eksperiencia e tij si dhe në vullnetin për të luftuar korrupsionin. Madje, ai theksoi se plotëson kriteret e përcaktuara në Kushtetutë për të drejtuar këtë institucion. "Detyrën e kreu të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të cilën unë jam propozuar për t'u zgjedhur e konsideroj si përgjegjësi shumë të madhe, që përputhet plotësisht me ambicijen për të vazhduar kontributin në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm edhe të këtij institucioni në dobi të vendit, me qëllim optimizimin e menaxhimit të parasë publike. Parandalimi i korrupsionit dhe abuzimet me fondet publike përbëjnë misionin themelor të këtij institucioni", theksoi z.Shaqiri. Pavarësisht vlerësimit të figurës së Shaqirit, prova në Komisionin e Ekonomisë është cilësuar e pa kaluar nga Arben Ahmetaj. "Nuk rezultoi që kandidati gjatë gjithë karrierës së tij të ketë përvojë profesionale në fushën financiare dhe veçanërisht në çështjet e auditimit të jashtëm. Pro Shaqirit janë shprehur vetëm dy deputetët e LSI-së, që ishin prezentë në komision", tha z.Ahmetaj. Madje, ata deklaruan se vendimi ishte paravendosur.



**BAHRI SHAQIRI**

"Detyrën e kreu të KLSH për të cilën unë jam propozuar për t'u zgjedhur e konsideroj si përgjegjësi shumë të madhe, që përputhet plotësisht me profesionalizimin tim dhe me ambicijen për të vazhduar kontributin në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm edhe të këtij institucioni në dobi të vendit, me qëllim optimizimin e menaxhimit të parasë publike", tha z.Shaqiri.

## Lleshi refuzon PD në Komisionin e Medias, Vokshi: Akti antikushtetues

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshi, refuzoi dje kërkesën e deputetëve të opozitës për të raportuar në Komisionin e Medias për dhunën e ushtruar ndaj studentëve brenda në godinë të fakulteteve. Ndryshe nga herët e tjera ku ishim mësuar me mungesën e opozitës, këtë të martë punën e komisionit e bojkotuan socialistët. "Bojkotimi i mbledhjeve të komisionit nga deputetët e mazhorancës, si edhe refuzimi i ministrit të Brendshëm me urdhr të Edi Ramës është një akt antikushtetues", deklaroi deputetja Vokshi. Deputetët e mazhorancës u shprehën se ata nuk morën pjesë në mbledhjen e komisionit, pasi mbërmen e së hënës kishin marrë përgjigje negative për praninë e ministrit. Gjithashtu, socialistët shprehën se Sandër Lleshi është shprehur i gatshëm për të ardhur në komision, por më parë duhet të konsultohen me të për të përcaktuar agjendën. Nga ana tjetër deputetët e opozitës, me në krye kryetaren e komisionit, Albana Vokshi kanë firmosur kërkesën për të thirrur në mbledhje ministrin e Brendshëm në datën 6 Shkurt, në orën 11:00.



**PD kërkon shtyrjen e afatit të komisionit**

**Konferenca e Kryetarëve mbledhet sot për Tahirin, Paloka: U pengua hetimi**

Konferenca e Kryetarëve do të mbledhet sot në orën 12:00 për çështjen "Tahiri". Partia Demokratike do të kërkojë shtyrjen e afatit të Komisionit Hetimor për çështjen e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Nënkrjetari demokrat, Edi Paloka, deklaroi se puna e komisionit është penguar nga institucionet që duhet të japin informacion. Ndaj, ai kërkon që çdo institucion që nuk i përgjigjet komisionit të mbajë përgjegjësi ligjore. PD kërkon shtyrje të afatit të komisionit dhe të mbajnë

**DEKLARATA**  
Nënkrjetari demo-krat, Edi Paloka, deklaroi se puna e komisionit është penguar nga institucionet që duhet të japin informacion. Ndaj, ai kërkon që çdo institucion që nuk i përgjigjet komisionit të mbajë përgjegjësi ligjore. PD kërkon shtyrje të afatit të komisionit dhe të mbajnë përgjegjësi

ata që nuk u janë përgjigjur kërkesave të komisionit, ministri i Brendshëm dhe drejtori i përgjithshëm i

Policisë së Shtetit, që nuk ka sjellë informacion për Tahirin. Mësohet se nënkryetari i PD-së, njëherazi dhe nënkryetari

rietar i parlamentit, Edi Paloka ka bërë një kërkesë për mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve në lidhje me zgjatjen e afatit të komisionit



Nënkrjetari demokrat, Edi Paloka

hetimor për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Kërkesa për zgjatjen e komi-

sionit hetimor është bërë nga PD që në nisje të komisionit hetimor për ish-ministrin e Brendshëm.

Kreu i PD flet për babanë në spital: U tmerrova, 6 nga 7 infermierët do largoheshin

**Protesta e 16 shkurtit, Basha: I hapet rrugë qeverisë transitore**

*"Stazhe punësimi për 10 mijë studentë në vit"*

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, ishte dje në Shkodër në vijim të turit të takimeve për përgatitjen e protestës së 16 shkurtit. Z.Basha takoi studentët, tregtarët dhe qytetarë të shumtë shkodranë, të cilët i ftoi në protestën e 16 shkurtit për rrëzimin e Edi Ramës nga pushteti dhe krijimin e një qeverie tranzitore që u hap rrugë zgjedhjeve të lira. Vendimi i parë që do të marrë qeveria demokratike kur të vijë në pushtet, do të jetë anulimi i ligjit të arsimit të lartë. Në një takim në Shkodër me studentët të universitetit, Lulzim Basha e cilësoi ligjin korruptiv. Ai premtoi lehtësira financiare për studentët që vijnë nga familjet në nevojë si dhe hapjen e stazheve të punësimit për 10 mijë studentë në vit. "Duke zëruar tarifat për bachelor dhe master për të gjitha familjet nën 640 mijë lekë me të ardhura në muaj. Përgjysmim për familjet me të ardhura mbi 640 mijë lekë në muaj. Duke mbështetur 5 mijë studentë që vijnë nga nevojë ekstreme ekonomike me bursa deri në 2 milionë e 200 mijë lekë të vjetra në vit, për qira, ushqim, librat dhe shpenzime të tjera të jetës studentore", tha z.Basha. Kreu i PD-së ftoi studentët t'i bashkohen protestës që do të nisë sipas tij, rrëzimin e qeverisë. Kreu demokrat përsëriti edhe një herë qëndrimin e tij për qeveri tranzitore për të përgatitur zgjedhjet të lira teksa premtoi: "Për 10 mijë studentë në vit do të ofrohen stazhe punësimi njëvjeçare me pagë 300 mijë lekë të vjetra në muaj, që do të bëjë të mundur që një student të mos dalë dhe të lihet mes katër rrugëve, por të fillojë të integrohet në tregun e punës. Natyrisht, e gjitha kjo funksionon vetëm si një pjesë e një plani të përgjithshëm", u shpreh z.Basha. Para takimit me studentët, Basha u takua me tregtarët e qytetit të Shkodrës, të



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Shkodër

**SOCIALISTI**

Një qytetar nga Shkodra, i cili tha se është socialist, i kërkoi kreut të opozitës që të dalin në shesh të rrëzojnë kryeministrin brenda 24 orëve. Ai u shpreh: "Me ardhë në Tiranë dhe me e hek brenda 24 orëve këtë legen". Ndërsa Basha u drejtua: "Më datë 16 e vendosni ju!"

cilëve u premtoi lehtësira financiare për aktivitetin e tyre privat. Kërkesa kryesore e liderit të opozitës ishte bashkimi në protestën e 16 shkurtit. Basha u shpreh se gjuha e popullit është zgjidhja e vetme për largimin e qeverisë "Rama" pasi kanë mbaruar të gjitha mjetet politike. "Më 16 shkurt shqiptarët do të zgjidhin kontratën me këtë qeveri, që ka shkelur çdo kontratë sociale me popullin dhe do i hapë rrugë një zgjidhjeje politike, një qeverie kalimtare, zgjedhjeve të lira e të ndershme, ku të kemi një parlament të popullit dhe qeveri të popullit. Unë si kryetar i PD-së do prezantoj zgjidhjet,

të cilat do i dëgjoni në prani të forumeve, grupeve të interesit dhe miqve tanë europianë që janë në krahun tonë dhe në krahun e qytetarëve", u shpreh kreu i PD-së.

**HISTORIA**

Kreu i Partisë Demokratike gjatë takimeve të tij në Shkodër tregoi një histori personale që i ka ndodhur në spital. Z.Basha tregoi se një

vit më parë, teksa kishte shtruar në një nga departamentet e QSUT-së babanë e tij për një ndërhyrje komplekse, ishte tmerruar kur kishte mësuar ikjen e 6 infermierëve nga 7 në total. Duke i cilësuar "heronj" të papërfillur për nga paga që merrnin, Basha u shpreh se në atë moment u ndje keq në planin njerëzor, pasi po i largoheshin bashkatdhetarë. "Një vit më parë mu desh të shtroja tim atë në një nga departamentet e QSUT-së për një ndërhyrje goxha komplekse. Falë Zotit e kaloi shumë mirë, por me këtë rast mu desh të kaloja goxha kohë pranë tij dhe pashe me sytë e mi një pavijon, pavijonin e reanimacionit, ku punon 7 infermierë, të cilët për nga aftësia profesionale, kompetencat profesionale, dhembshuria njerëzore që trajtonin çdo pacient, jo thjesht babën tim, por çdo pacient dhe për nga orari i zgjatur ishin heronj, merrnin edhe paga të papërfillshme. Aty mora vesh se brenda majit 6 prej infermierëve do të iknin. Natyrisht, më erdhi keq në planin njerëzor të largohen bashkatdhetarë, në këtë rast infermieret. U tmerrova duke menduar se si në këtë pavijon kërkohet një shërbim shumë i specializuar; pa prituri do të mbetet vetëm 1 infermiere", u shpreh z.Basha.

**QEVERIA**

"Më 16 shkurt shqiptarët do të zgjidhin 'kontratën' me këtë qeveri, që ka shkelur çdo kontratë sociale me popullin dhe do i hapin rrugë një zgjidhjeje politike, një qeverie kalimtare, zgjedhjeve të lira e të ndershme ku të kemi një parlament të popullit dhe qeveri të popullit", tha kreu i PD-së.



**Berisha: Rama në Berlin si patologjik, nuk e priti askush**

Ish-kryeministri Sali Berisha shprehet se kryeministri Rama nuk e ka prituri askush në Berlin, ndonëse sipas tij, ishin njoftuar konfidentët për takime në nivele të larta në Kancelari, Bundestag dhe në Ministri të Jashtme. "Në Berlin Kallam Dëshakun nuk e priti njeri! Atje flitet për një patologjik! Kallam Dëshakun javën e kaluar i vuri kyçin parlamentit, Kryeministrit dhe sarajeve të Surrelit. Ai vraoi në Berlin në pretekst e një ekspozite shkarravinash të denja për një adoleshent të droguar. Sugari Fuga dhe Sugari Cakaj kishin njoftuar konfidentët për takime në nivelet më të larta në Kancelari, Bundestag dhe Ministri të Jashtme. Por, asnjë nga këto takime nuk u realizua. Në Berlin flitet gjerësisht se është një patologjik. Ai u kthye ashtu siç shkoi, pa asnjë takim të paralajmëruar", shkruan Berisha në "Facebook".

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 16.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-rë për shpëtim e pasurisë së palajtmishme. Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 2/139/ND+1-13, vullmi 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lajta 13, Plazh, Hyrja 1, Ap. 13 Durrës, në pronësi të Z.Çirim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bartha Xhema Xhafa me vlerë fillestare në ankand 32.468 (Tridjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shpëtim e pasurisë së palajtmishme, Arë me sip.1,500 m<sup>2</sup> me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankand 378.000 (Treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Agjencia e Trajtitimit të Pronave, formulari për kompensim, kostoja e aplikimit është 2000 lekë

# Kartela e pronës/ Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, aplikimi

## Shtatë dokumentet që duhet të dorëzohen në ATP

Të gjithë pronarëve që u zënë është toka nga ndërtimet pa leje, për të marrë kompensimin duhet të plotësojnë formularin-tip dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave. Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën-tip, që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë ATP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka publikuar kartelën informative, ku të gjithë personat që presimin kompensimin mund të marrin informacion në lidhje me dokumentet që duhet të dorëzojnë, afatet dhe vlerën e kompensimit.

### PRANIMI I KËRKESAVE

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

### DOKUMENTET

Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

KARTELE INFORMATIVE		ALB02011																																
1. Emri i shtetit	Kërkesa për kompensim në vlerë për pronat e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale (AL02011)																																	
2. Cilë është qëllimi i shtetit?	Akti dhe të tëra shprehin informacione për kompensim, pronë e të cilave është akti nga ndërtimet informale																																	
3. Çfarë shpreh ky shtet?	Vendimi për kompensim e pronarëve të prekur nga ndërtimet informale																																	
4. A janë përfitues?	Pronarët pronë private e të cilave është prekur nga ndërtimet informale. Trashëgimtarët e pronarëve, pronë e të cilave është prekur nga ndërtimet informale																																	
5. Çfarë dokumentesh duhet për aplikim?	<table border="1"> <tr> <th>Nr</th> <th>Lloji</th> <th>Dokumentet kërkesat nga</th> <th>Dokumentet në shtet nga aplikimi?</th> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Dëshmia trashëgimore për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues në rast se ka trashëgimtarë të ligjshëm të subjektit përfitues</td> <td>Agjencia</td> <td>Po</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Dokumentet shprehin vendimin e gjykatës për testamentin e bërë me akt noterial</td> <td>Zyra e Spjegimit Civil</td> <td>Po</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Vendimi për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit</td> <td>Banka</td> <td>Po</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Mandati për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit</td> <td>Banka</td> <td>Po</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Mandati për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit</td> <td>Banka</td> <td>Po</td> </tr> </table>	Nr	Lloji	Dokumentet kërkesat nga	Dokumentet në shtet nga aplikimi?	1	Dëshmia trashëgimore për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues në rast se ka trashëgimtarë të ligjshëm të subjektit përfitues	Agjencia	Po	2	Dokumentet shprehin vendimin e gjykatës për testamentin e bërë me akt noterial	Zyra e Spjegimit Civil	Po	3	Vendimi për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit	Banka	Po	4	Mandati për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit	Banka	Po	5	Mandati për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit	Banka	Po	<table border="1"> <tr> <th>Zyra pritëse</th> <th>Ora</th> <th>Adresa</th> <th>Ora</th> </tr> <tr> <td>Spjegimet / Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>08:00 - 16:00</td> <td>Sh. "Mulltarit Gjilnari", Nr 54, Tiranë</td> <td>08:00 - 16:00</td> </tr> </table>	Zyra pritëse	Ora	Adresa	Ora	Spjegimet / Agjencia e Trajtitimit të Pronave	08:00 - 16:00	Sh. "Mulltarit Gjilnari", Nr 54, Tiranë	08:00 - 16:00
Nr	Lloji	Dokumentet kërkesat nga	Dokumentet në shtet nga aplikimi?																															
1	Dëshmia trashëgimore për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues në rast se ka trashëgimtarë të ligjshëm të subjektit përfitues	Agjencia	Po																															
2	Dokumentet shprehin vendimin e gjykatës për testamentin e bërë me akt noterial	Zyra e Spjegimit Civil	Po																															
3	Vendimi për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit	Banka	Po																															
4	Mandati për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit	Banka	Po																															
5	Mandati për hapjen e procesit të ligjshëm të trashëgimit	Banka	Po																															
Zyra pritëse	Ora	Adresa	Ora																															
Spjegimet / Agjencia e Trajtitimit të Pronave	08:00 - 16:00	Sh. "Mulltarit Gjilnari", Nr 54, Tiranë	08:00 - 16:00																															
6. Ku mund të aplikohet?	<table border="1"> <tr> <th>Niveli 1</th> <th>Niveli 2</th> <th>Niveli 3</th> <th>Niveli 4</th> </tr> <tr> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi shprehin informacione / mundësi të aplikimit</td> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> </tr> </table>	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi shprehin informacione / mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit																									
Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4																															
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi shprehin informacione / mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit																															
7. A është ky shtet përfitues?	<table border="1"> <tr> <th>Niveli 1</th> <th>Niveli 2</th> <th>Niveli 3</th> <th>Niveli 4</th> </tr> <tr> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> </tr> </table>			Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit																							
Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4																															
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit																															
8. Sa është nevojshet për të marrë shtetin?	<table border="1"> <tr> <th>Tarifa bazë</th> <th>Tarifa shtesë</th> <th>Tarifa Online</th> <th>Marrja e pasurisë</th> </tr> <tr> <td>0 lekë</td> <td>0 lekë</td> <td>0 lekë</td> <td>0 lekë</td> </tr> </table>			Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Marrja e pasurisë	0 lekë	0 lekë	0 lekë	0 lekë																							
Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Marrja e pasurisë																															
0 lekë	0 lekë	0 lekë	0 lekë																															
9. Çfarë shpreh ky shtet?	Njoftimi për informacione e vlerë të kompensimit																																	
10. Në cilin vlerësohet ky?	Pa vlerë																																	
11. Në cilin vlerësohet ky?	<table border="1"> <tr> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>0</td> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>0</td> </tr> </table>			Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0																											
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0																															
12. Në cilin vlerësohet ky?	<table border="1"> <tr> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>0</td> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>0</td> </tr> </table>			Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0																											
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	0																															
13. Cilë është institucioni përfitues?	<table border="1"> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Ora</th> </tr> <tr> <td>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</td> <td>08:00 - 16:00</td> </tr> <tr> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> <td>08:00 - 16:00</td> </tr> <tr> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> <td>08:00 - 16:00</td> </tr> <tr> <td>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</td> <td>08:00 - 16:00</td> </tr> </table>			Kategoria	Ora	Agjencia e Trajtitimit të Pronave	08:00 - 16:00	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	08:00 - 16:00	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	08:00 - 16:00	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	08:00 - 16:00																					
Kategoria	Ora																																	
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	08:00 - 16:00																																	
Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	08:00 - 16:00																																	
Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	08:00 - 16:00																																	
Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	08:00 - 16:00																																	
14. Në cilin vlerësohet ky shtet?	<table border="1"> <tr> <th>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</th> <th>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</th> <th>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</th> <th>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</th> </tr> <tr> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </table>			Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	0	0	0	0																							
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit																															
0	0	0	0																															
15. Në cilin vlerësohet ky shtet?	<table border="1"> <tr> <th>Agjencia e Trajtitimit të Pronave</th> <th>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</th> <th>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</th> <th>Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit</th> </tr> <tr> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </table>			Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	0	0	0	0																							
Agjencia e Trajtitimit të Pronave	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit	Spjegimet informacionale dhe mundësi të aplikimit																															
0	0	0	0																															

Faksimile e formularit për kompensim

### DOKUMENTET

1. Kërkesa-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë ATP-së, të plotësuar sipas rubrikave.
2. Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi (në rast se subjekti përfitues ka vdekur).
3. Prokurë e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si

- tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre. Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët për pjesën takuese në pronë që kompensohet.
4. Vërtetimin original i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare dhe IBAN-in përkatës.
5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
6. Certifikatë familjare të kërkuarit/aplikuesit.
7. Mandatpagesa për shumën 2 000 lekë për çdo aplikim të veçantë.

## Rikthehet projekti i HEC "Skavicës", nis hartimi i studimit të fizibilitetit

Projekti i hidrocentralit të Skavicës është rikthyer edhe një herë në tryeza teknike për të parë mundësinë e zbatimit të tij. Këtë të martë Korporata Elektroenergetike Shqiptare bëri me dije se ka nisur puna për hartimin e studimit të fizibilitetit për këtë projekt si dhe për të bërë vlerësimin social-mjedisor të tij. Grupi i konsulentëve të grupi i konsulentëve të Konsorciumit IPP6 (Infrastructure Project Facility) me financimin e WBIF (Western Balkan Investment Framework) ka në fokus të tij projektin "Skavica Hydro Poëer Plant: Feasibility Study and ESIA. KY grup do të përgatisë Studimin e Fizibilitetit dhe do të realizojë Vlerësimin e Ndikimit Social-Mjedisor dhe në fund të periudhës 21-mujore që të japë opsionet për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumen Drin. Skavica është pjesë e kaskadës së Drinit. Ai u projektua në vitet '70 të ishite hidrocentrali i parë i kësaj kaskade para Fierzës, ndërkohë që

### STUDIMI

Skavica u planifikua që të ndërtohej me një fuqi të instaluar 350 megavat, por ky variant u përgjysmua në një tjetër studim që bëri pak vite më parë kompania SOGREA, e cila u zgjodh nga qeveria Berisha për të bërë studimin e varianteve më të përshatshme për ndërtimin e këtij HEC-i. Në atë kohë projekti i zgjedhur për hidrocentralin e Skavicës parashikonte një fuqi të instaluar prej rreth 170 megavat.

në total në këtë kaskadë ishin projektuar pesë HEC-e. Në renditje do të ishin Skavica, Fierza, Vau i Dejës, Komani dhe Bushati. Hidrocentrali i parë dhe i fundit i kaskadës nuk gjetën zbatim. Fillimisht Skavica u planifikua që të ndërtohej me një fuqi të instaluar 350 megavat, por ky variant u përgjysmua në një tjetër studim që bëri pak vite më parë kompania

SOGREA, e cila u zgjodh nga qeveria Berisha për të bërë studimin e varianteve më të përshatshme për ndërtimin e këtij HEC-i. Në atë kohë projekti i zgjedhur për hidrocentralin e Skavicës parashikonte një fuqi të instaluar prej rreth 170 megavat. Madhësia e hidrocentralit, krahasuar me projektin e vjetër u ul, pasi kompania "SOGREA" dhe KESH-i



kërkuan një projekt që do të merrte parasysh edhe pjesën sociale, duke minimizuar mundësitë e përmblyetjeve në zonë, si dhe për të pasur një kaskadë të sigurt. Për Skavicën ka pasur interes edhe më vonë nga kompani të huaja. Në vitin 2014 përfaqësuesit e dy kompanive turke "Suzer Group" dhe "Nurul Holding" shfaqën interes për ndërtimin e Skavicës. Në

vitin 2016 do të prezantoheshin dy opsione të tjera, ku njëri prej tyre parashikonte ndërtimin e dy hidrocentraleve ku i pari në 445 metra mbi nivelin e detit të quajtur Katund i Ri dhe i dyti Skavica, në kuotën 395 metra mbi nivelin e detit. Investimi për të dy HEC-et llogaritet në 348 milionë euro dhe një prodhim vjetor në rreth 649 milionë kWh.

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbares gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyjra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 27.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III-të për shpëtim të pasurisë së paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 112 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr pasurisë 161/36, Vll.6, Fq.122, ZK.8516 në pronësi të Shoqërisë "KORRATKA BISTON" Sh.P.K., me adresë Durres, me vlerë filltare në ankand 7.338.6 (Shtatë mijë e triqind e tridhjetë e tetë pika gjashtë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme, Trulli me sipërfaqe totale 1260 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr pasurisë 162/35, Vll.7, Fq.236, ZK.8516 në pronësi të Shoqërisë "KORRATKA BISTON" Sh.P.K., me adresë Durres, me vlerë filltare në ankand 82.555 (Etdhjetë e dhjetë e pesëqind e pesëqindë e pesë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbares gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyjra 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 01.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i I-rë për shpëtim të pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/229, ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m2 me adresë Tiranë, në pronësi të Z.Bujar Musa Kajtazi me vlerë filltare në ankand 98,880 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.



## AKU bllokoi në Durrës 41.7 tonë banane të prishura, të ardhura nga Kosta Rika

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bllokuar 41.7 tonë banane të prishura të ardhura nga Kosta Rika. Pas bllokimit të sasisë së bananeve të prishura, AKU shprehet se do të kryhen të gjitha procedurat për ta kthyer mallin në vendin e origjinës. Ndërkohë, ky institucion deklaron se do të jetë gjithnjë në krah të

qytetarëve, ndërsa fton këta të fundit të denoncojnë çdo rast që cenon sigurinë e tyre ushqimore. "Në kuadër të forcimit të masave për Sigurinë Ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka në fokus të veçantë kontrollin në Pikat Doganore në të gjithë vendin. Konkretisht, trupa inspektuese e DRAKU, Durrës gjatë kontrollit të

ushtruar në PIK ka konstatuar dhe bllokuar një ngarkesë prej 41.7 tonë banane të ardhur nga Kosta Rika për shkak se produkti rezultoi me probleme për konsum njerëzor-produkti i prishur. Menjëherë nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit u bë bllokimi i ngarkesës me sasi 41.7 tonë, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, gjith-

ashtu, do të ndiqen procedurat doganore për kthimin në origjinë. AKU thekson se do të jetë gjithmonë në mbështetje të konsumatorit, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore. Gjithashtu, inkurajon të gjithë qytetarët të denoncojnë çdo rast, çdo tentativë abuzimi pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në info@aku.gov.al si dhe pranë portalit të bashkëqeverisjes 'Shqipëria që duam'. Siguria ushqimore është një sfidë e përbashkët", thuhet në njoftim.

De Raho: Lufta ndaj krimit dështon, dhe nuk merremi me mekanizmin financiar

TIRANË

Dy janë formatat për goditjen e krimit dhe korrupsionit: ndjekja e parasë dhe ndalimi i kontakteve të të burgosurve me jashtë, që Shqipëria e ka huzuar pikërisht nga Italia. Krimi shqiptar është i specializuar në trafikun e drogë e lëndëve narkotike". Kështu deklaroi dje prokurori i Antimafies italiane, Federico Cafiero De Raho, gjatë konferencës të organizuar nga Ministria e Drejtësisë për luftën kundër krimit të organizuar dhe masat brenda sistemit të burgjeve, bazuar në eksperiencën italiane, i njohur në Itali si platforma 41 biss, ose "burgu i egër". Ndërkaq, prokurori De Raho kërkoi veprim të institucioneve shqiptare për të parandaluar që organizatat kriminale të trafikuar të drogës t'i rinvestojnë paratë në ekonominë shqiptare. Jam dakord me Sorecën kur tha se formula më e efektive për goditjen e krimit është ndjekja e parasë, por edhe ndalimi i kontakteve mes të burgosurve dhe atyre që janë jashtë burgjeve. Krimi shqiptar është i specializuar në trafikun e lëndëve narkotike, hetime të shumta janë duke u zhvilluar në Itali dhe vende të tjera. Të gjitha drejtoritë e rrethëve në Itali janë duke hetuar për këtë gjë dhe që përfshijnë edhe shqiptarë. Rezultoni se është rritur edhe trafikun e armëve, të mendojmë për shfaqjen e terroristit ku mund të zbatohet. E përsërisim ne, por edhe agjencitë ndërkombëtare, çdo veprim në luftën ndaj kriminalitetit do të falimentojnë nëse nuk merret mekanizmi financiar. Të sulmohet sistemi, subjektet që i bëjnë të mundur trafikantëve" u shpreh De Raho. Ndërsa tha se, "instrumentet që ka në dispozicion legjislatura shqiptare të përdoren me rigorozitet. Të kthejmë besimin në shtet dhe institucionet shtetërore. Një e ardhme në Europë ndërtohet përmes një luftime të paseshtur ndaj luftës kundër kriminalitetit dhe korrupsionit. Drejtoria Antimafie është e gatshme të ofrojë asistencën e vet edhe

# Prokurori i Antimafies italiane: Pastrimi i parave bëhet këtu, krimi drejtohet nga burgu

## Grupet kriminale investojnë miliona euro në Shqipëri

### MAFIA

Prokurori i Antimafies italiane deklaroi dje se, "ekziston një probabilitet shumë i lartë që riciklimi i të ardhurave nga aktiviteti kriminal bëhet në vendin e origjinës të bashkëpunësorëve të organizatës kriminale: në rastin e qytetarëve shqiptarë, pikërisht në Shqipëri. Në rast se të ardhurat e organizatave kriminale do të ishin ri-investuar në Shqipëri, mafia do të kishte mundësinë të bëhej investitori kryesor në këtë vend dhe kjo do të ishte e frikshme në mënyrë të dëshpëruar".



Prokurori i Antimafies italiane, Federico Cafiero De Raho

sa i përket legjislacionit për burgjet. Aktiviteti kriminal të mos drejtohet nga burgjet. Kapot historikë të grupeve mafioze të ndalohen të veprojnë nga burgu". Në përfundim të konferencës, Federico Cafiero De Raho, i pyetur nga gazetarët nëse në Shqipëri ka ndryshuar diçka krahasuar me herën e fundit kur ishte në vendin tonë, ai vlerësoi punën që po bëhet, ndërsa shtoi se grupet shqiptare në Itali veprojnë jo vetëm në trafikun e marijuanës, por edhe kokainës duke bërë aleancë me bandat italiane. "Ka ndryshuar shumë nga hera e parë. Ka pasur bashkëpunim për hetim nga pala italiane dhe shqiptare për të luftuar krimin që vepron në të dyja vendet. Shqiptarët në Itali veprojnë jo vetëm në trafikun e marijuanës, por edhe kokainës, ndërsa kanë aleancë me organizatat kriminale në Itali, si 'Ndrangheta'. Fitimet e grupeve kriminale investohen në Shqipëri", deklaroi ai. Ndërkaq, ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj tha nga ana e saj se lufta kundër krimit të organizuar është

një prioritet absolut i qeverisë shqiptare dhe se Italia ka qenë e pranishme në çdo hap në luftën kundër krimit të organizuar. Ajo pohoi se shumë shpejt do të prezantohet paketa antikrim, që përf-

shin edhe ndryshimin e Kodit Penal në Shqipëri. "Aktualisht janë ngritur KLP dhe KLGJ dhe së shpejti ngrihen edhe SPAK, strukturë e posaçme kundër krimit dhe korrupsionit, në kuadër të

zbatimit të reformës në drejtësi, çka do të çojë në ndjekjen e veprave penale në nivelet më të larta të administratës publike", u shpreh Gjonaj.

### DEKLARATA E AMBASADORIT SORECA

Në konferencën e djeshme ishte i pranishëm edhe ambasadori i Bashkimit Europian në Tiranë, Luigi Soreca, i cili vlerësoi operacionet e fundit për goditjen e krimit dhe sekuestrimin e pasurive të paligjshme. Ndërkohë, ai kërkoi që të vijohet me këtë ritëm, pasi këtu do të bazohet edhe vendimi për hapjen e negociatave në qershor. "Është fillimi dhe ne presim vendime përfundimtare të konfiskimit të pasurive të paligjshme, është sinjal që vendi po bën në luftën kundër krimit. Vendimi në qershor do të merret edhe në bazë të rezultateve në luftën kundër krimit", tha ndër të tjera Soreca.

## Kristo Ruçi, me precedentë për vjedhje e drogë

### Grabiti me kallashnikov bankën, policia dhe FNSH lokalizojnë vendndodhjen e 25-vjeçarit



25-vjeçarin Kristo Ruçi

tuar për vjedhjen e një automjeti në ambientet e spitalit rajonal të Gjirokastrës. Ngjarja kishte ndodhur në mars të 2016, ku Kristo Ruçi së bashku me disa persona të paidentifikuar kanë vjedhur automjetin tip "Benz", në pronësi të B.M., 54 vjeç, banues në Pier. Policia në atë kohë arrestoi të riun. Aktualisht 25-vjeçari ishte në kërkim për kultivim dhe transport droge. Policia e kishte shpallur në kërkim 25-vjeçarin në nëntor të vitit të kaluar, pasi në kuadër të operacionit anti-

drogë "Prita 2" dyshohet se drejtonte mjetin me 30 kg drogë. "Gjithashtu, është bërë shpallja në kërkim e shtetasit K.R., 25 vjeç, banues në Tepelenë, pasi nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se ka qenë drejtues i automjetit me targë AA 523 DF ku u gjet 30 kg kanabis", thuhet në njoftimin e policisë më datë 23 nëntor 2018. Policia është vënë në ndjekje të tij, duke përdorur të gjitha format e metodat operacionale dhe hetimore për të bërë të mundur kapjen.



Motrat e Aleko Petros në "News 24": E donim shumë, ja çfarë tha Anxhelina më 1 janar

# E vrau babai dhe e groposi në oborr, halla e Anxhelinës: Mbesa u përdhunua 13 vjeçe

*Vojsava Guri: Vajza erdhi tek ne se nuk e donte më nënën, ndaj u bashkua me të atin*

TIRANË

Afro një muaj pas ngjarjes makabre të ndodhur në Korfuz, është rikthyer dje në studion e emisionit "Me zemër të Hapur", në "News 24" historia e 29-vjeçares Anxhelina Petro, e cila u vra dhe u gropos në oborrin e banesës nga babai, Alekos Petro. Hallat e viktimës treguan dëshmi të reja, ndërsa pohuan se ajo ishte përdhunuar në moshën 13-vjeçare kur jetonte me të ëmën. Sipas tyre, që nga ai moment, vajza u shkëput prej nënës. Njëra nga motrat e Aleko Petros dhe konkretisht Vojsava Guri rrëfëu lidhjen që ka pasur me Anxhelinën, por edhe me të vëllain. Ajo ka treguar ekskluzivisht për "News 24" si e mësuan lajmin e kobshëm, bisedat që ka shkëmbyer me mbesën më 1 janar të këtij viti si dhe telefonatën nga burgu me vëllain (autor i kimit).

**Vojsava Guri:** Në vitin 2013 ndodhi dhe aksidenti që e përdhunuan, ka ardhur te motra Anxhelina dhe i ka thënë halla nuk duroj dot më...

**Sa vjeçe ishte?**

**Vojsava Guri:** Vajzën e përdhunuan kur ishte 13 vjeçe. Në 2005 erdhi tek ne.

**Kush është përgjegjësi?**

**Vojsava Guri:** Fillimisht nëna e saj e denoncoi personin, pastaj shkoi e tërhoqi denoncimin se kërkoi para. Vajza erdhi tek ne se nuk e donte më nënën, këtë nuk ia falte. Ndaj u bashkua me të atin.

**A kenë qenë në dëgjim për dhunë fizike të ushtruar nga babai?**

**Vojsava Guri:** Asnjëherë. Mediat greke thonë se vajza e ka denoncuar disa herë?

**Vojsava Guri:** Nuk dimë gjë, nuk na janë ankuar.

Ndërkaq, nëna e Anxhelina Petros, Xhezmija ka replikuar me hallat e së ndjerës në një lidhje telefonike me emisionin "Me zemër të Hapur". Ajo ka pranuar se vajza është përdhunuar, por kjo ka ndodhur kur ajo ishte minorene dhe se autori ka marrë dënim nga drejtësia.

Mes tjerash, Xhezmië Hoxhallari theksoi se nuk ishte në dëgjim se Anxhelina kishte studiuar në Greqi në drejtimet psikologji dhe fizioterapi.

**Xhezmië Hoxhallari:** Dëgjomë mua. Këto historira ndaj t'i hapin dhe ndaj të mos hapin. Mua nuk më intereson. Mbas ankesës që kam bërë unë, ai mori një dënim. Unë ia kam lënë shtetit. Nuk kam hequr asnjë denoncim dhe asnjë gjë. Të dy kanë qenë minorene. Janë histori të vjetra. Vajza ka ikur kur e kam lënë unë me deklarata tek babai, sepse donte një jetë më të mirë. Kam letrat dhe jam shumë e sjellshme me dokumente.

**Ju kenë qenë në dëgjim se**



Hallat e viktimës, dje në "News 24"



29-vjeçarja, Anxhelina Petro

## REAGIMI I NËNËS SË VIKTIMËS

Nëna e Anxhelina Petros, Xhezmië Hoxhallari ka replikuar me hallat e së ndjerës në një lidhje telefonike me emisionin "Me zemër të Hapur". Ajo ka pranuar se vajza është përdhunuar, por kjo ka ndodhur kur ajo ishte minorene dhe se autori ka marrë dënim nga drejtësia. "Këto historira n'daj t'i hapin dhe n'daj të mos i hapin. Mua nuk më intereson. Mbas ankesës që kam bërë unë, ai mori një dënim. Unë ia kam lënë shtetit. Nuk kam hequr asnjë denoncim. Të dy kanë qenë minorene. Janë histori të vjetra. Vajza ka ikur kur e kam lënë unë me deklarata të babai, sepse donte një jetë më të mirë".

## NGJARJA NË KORFUZ

Ngjarja e rëndë ndodhi në Alepou, Korfuz, në 2 janar. Babai shqiptar Bardhyl Guri, i njohur në Greqi si Aleko Petro vrau vajzën Anxhelinën 28-vjeçare dhe më pas e varrosi në oborrin pas shtëpisë për të fshehur gjurmët, pasi ishte kundër lidhjes së saj me një të ri nga Afganistani. Ka qenë partneri i saj nga Afganistani që ka bërë denoncimin, pasi nuk po arrinte që të kontaktonte me 28-vjeçaren. Ai ishte i pari që ngriti dyshimet se vajza mund të ishte vrarë, pasi i ati nuk pranonte lidhjen midis të rinjve. Qeni besnik i vajzës shqiptare i drejtoi hetuesit në vendin ku Aleko Petro kishte varrosur të bijën.

## vajza ka mbaruar psikologji dhe fizioterapi?

**Xhezmië Hoxhallari:** Këtë nuk e di. S'kam pasur komunikime. Ai person e donte vajzën time si skllave. Nuk më ka dalë vajza mua në telefon. Hapni dhe shikoni mesazhet. Unë me ju nuk jam koicinduar asnjëherë. Nuk kam komunikuar asnjëherë me ju. Vajza ime ka punuar tri punë dhe të gjithë kanë ngrënë lekët e vajzës sime, që mos i ngrëshin.

## Si e mësuan ngjarjen e rëndë?

**Halla Vojsava Guri:** Në datën 3 e pamë tek "News 24" lajmin, por emri ishte ndryshe dhe nuk na vajti mendja, kur kalon pak kohë, më merr mami dhe më njofton që është vrarë Anxhelina. Pas një ore na vjen edhe poli-

cia dhe thotë që Aleko ka vrarë Anxhelinën. U bëmë të forta se na erdhi e papritur, se ne me vajzën folëm në datë 1.

## Çfarë komunikuat ju me ta në 1 janar?

**Vojsava Guri:** Vajza jetonte me qira prej 1 viti e gjysmë dhe jetonte te kjo nënoja, e kishte si nënë të dytë atë. Në tetor isha atje, vajza i kishte përgatitur ushqim, ia kishte sjellë të atit.

## Patë diçka të çuditshme tek vëllai juaj?

**Vojsava Guri:** Jo, jo asgjë. Kur isha tek vëllai në tetor, ai më tha pyeteni mos ka ndonjë djalë. Çupa mu përgjigj: Hallë nuk dua burrë!

**Nuk ju bëri përshtypje që jetonin vetëm, të ndarë nga njëri-tjetri?**

## Aleko Petro: S'e di si ndodhi, do i vete çupës atje...

"Ç'bëre vëlla", halla e 29-vjeçares tregon telefonatën me vëllain pas vrasjes

**TIRANË** - Aleko Petro, shqiptari që vrau për nder të bijën 28-vjeçare, Anxhelina Petro, pasi kundërshkonte lidhjen e saj me një afgan ka folur për herë të parë pas kimit me të afërmit e tij më datë 8 janar. I ndodhur në paraburgimin grek, Petro i ka telefonuar motrës së tij të vogël. Përmes lotëve, e ftuar në studion e emisionit "Me zemër të Hapur" në "News 24, motra e tij thotë se ai as vetë nuk e besonte krimin e rëndë që kishte bërë. "Më ka marrë në datën 8 janar, i thashë ç'bëre vëlla kështu?! Më tha atë që bëra nuk e di as vetë. Më tha mos u mërzisni se unë do t'i vete çupës atje. Më tha nuk e di si arritën gjërat deri në këtë



Babai i viktimës, Aleko Petro

pikë. I thashë çupa (trupi i saj) ka ardhur, është këtu dhe nuk na lënë ta shikojmë", tha halla mes lotësh. Ajo rrëfëu më tej se vëllai për dy orë nuk kishte mundur të fliste,

pastaj i kishte rrëfyer të gjithë krimin. "Motër më tha pastaj, se unë dy orë s'mund të flisja. Por isha unë ai që i tregova historinë që bëra policisë".

**Vojsava Guri:** Jo, jo se vajza donte një jetë pak më të mirë. Anxhelinën e donim shumë.

## Si e përjetoi largimin e vajzës vëllai juaj?

**Halla tjetër:** Ajo i tha do iki ta përballoj edhe unë jetën vetëm. Vajza e kishte marrë dhomën tek ajo nënoja, kishte një dhomë të vogël, ku jetonte.

## Ndalemi tek data 1, çfarë ndodhi?

**Halla tjetër:** Kemi folur në datë 1 edhe me video... nuk e ka vrarë as në 30 as në 31, por nuk ia fal këtë që ka bërë. Ai ka punuar shumë e ka bërë me shkollë atë va-

ajzën (shpërthen në lot). Ai sakrifikoji jetën për atë vajzë, e deshte me shpirt, nuk e di si ka ndodhur

## Biseda në 1 janar, çfarë patë ndonjë gjë që nuk shkonte, çfarë biseduat?

**Vojsava Guri:** Më mori vëllai dhe më pyeti si është mami, pastaj më tha që erdhi çupa. Folëm edhe më të mirë e bukur, nuk më tha as atë ditë, por as më parë ndonjë fjalë të keqe në drejtim të babait. Ne jemi të shokuar.

## Si ka qenë marrëdhënia e tyre?

**Halla tjetër:** I vetmi problem që mund të ketë pasur ai është që vajza nuk shkoni

te shpesh pasi iku nga shtëpia e vëllait dhe vizitat ia bënte rreth orës 11 të natës. Ai shqetësohej dhe i thoshte ku punon moji bijë? Por me sa dimë ne, ajo punonte si ndihmëskuzhinieri.

Ju i mëshoni faktit që Anxhelina ishte vajzë e re dhe donte një jetë tjetër? Çfarë mund të kishte ndodhur mes tyre?

**Vojsava Guri:** Ajo nuk pranonte që ai të ndërhynte në jetën e saj, jetën do ta bëj si di unë i thoshte. Dontë një jetë që të mos e rremonte asnjë. Kur ishin bashkë në shtëpi, ai i thoshte të vij të marr unë, ku punon?



Table with 5 columns: Name, ID, Date, Name, ID, Date, Name, ID, Date, Name, ID, Date. Lists names and IDs for various individuals, likely related to a social or legal case.



### Programme: Sustainable Development of the Rural Areas

Agriculture and rural development are of crucial with regard to socio-economic development in Albania as it accounts for 23% of the GDP and 42% of the overall employment. The majority of agri-cultural holdings is characterized by fragmented land use and small stock sizes. Significant structural deficits exist as well as weak advisory services and representation structures. In view of the aspired EU accession, a large proportion of farms and smaller processors are not sufficiently competitive. The consolidation of agriculture in the context of EU common agricultural policy and the current situation in rural areas require that the rural population has alternative income and employment opportunities. This is especially true for women and young people. Young people in particular leave the rural regions temporarily or completely in search of more attractive income opportunities. The strongest growth and employment impulses come from rural tourism. The further development of sustainable rural tourism depends heavily on the protection of natural and cultural landscapes and the sustainable exploitation of natural resources in rural areas. The environmental, economic and social potentials in rural areas are not yet sufficiently exploited to sustainably create and sustain diversified income and employment perspectives.

Starting in January 2019, a new BMZ-funded program on rural development will promote income opportunities in rural areas through increased competitiveness and diversification of agriculture, the valorization of biodiversity and the potential of rural tourism for employment-generating activities. The program will contribute to employment promotion in the agricultural sector and non-agricultural activities in rural areas by focusing on the principles and instruments of the EU's common agricultural policy for rural development. It promotes the participation of young people and women and thus contributes to gender equality. The program will apply an integrated approach on rural development with a focus on agriculture and rural tourism. It will consist of three interrelated fields of intervention (outputs):

- Output 1) Policy Advice for Rural Development
- Output 2) Promotion of Selected Value Chains (Cluster I: Tourism; Cluster II: Agriculture)
- Output 3) Improvement of Education & Training in Agriculture & Rural Tourism
- Output 4) Support to Agricultural Knowledge and Innovation System

The programme's duration is foreseen from 01/2019 – 12/2022.

**"Sustainable Development of the Rural Areas" programme, seeks the following staff:**  
Advisor – Tourism

#### A. Responsibilities

The advisor-tourism is responsible for:

- implementing daily operational aspects of all issues related to the project in the following fields:
  - a) policy advice in rural tourism with MoTE (output 1)
  - b) promotion of rural tourism and other value chains related to diversification (output 2)
  - c) identifying and coordinating education and training needs & measures in the field of rural tourism and diversification (output 3)
- support of public and private actors in developing, maintaining and quality assurance of rural tourism infrastructure, destination management products in close coordination with AMA Tourism
- support to planning, coordination and implementation of all activities related to rural tourism
- liaison with MoTE, regional and local tourism structures as well as other donors operating in the field of tourism
- innovation and knowledge management;
- maintaining of a good flow of communication and information between all involved institutions and counterparts and GIZ including regional projects
- ensuring that the contracting and spending of allocated funds run smoothly in his/her area of intervention

The advisor - tourism performs the following tasks:

#### B. Tasks

##### 1. Provision of advisory services

The advisor-tourism

- gives substantial input to development and review of capacity development strategy in his fields of intervention
- establishes and maintains good communication and cooperation with partners on central, regional and local level
- identifies the needs of government institutions, private partners and NGOs as well as the project's beneficiaries
- advises partner institution(s) regarding clarification and identifying needs, developing concepts and strategies, and provides technical input in his field
- participates in identifying needs for external support and advice, drafts terms of reference for local and international consultants, works on policy recommendations and develops a strategic approach
- designs, prepares and conducts project activities and carries out other activities required for implementing outputs 1 and 2 in the field of rural tourism and diversification in close coordination with AMA Tourism and the relevant Albanian partners based on needs
- participates in formulating project activities and helps synchronise the planning and budgeting system and counterparts
- is jointly responsible with the partner institution and AMA Tourism for preparing, implementing and documenting training events, workshops, forums, and other project activities
- monitors the development, implementation and results of activities in his fields of intervention in close consultation with counterparts and AMA Tourism
- support to program monitoring requirements

##### 2. Communication and networking

The advisor-tourism

- develops and maintains contact with all important stakeholders
- provides technical assistance to local and international experts
- ensures knowledge management: collects, processes and distributes relevant information, monitors communication and interaction between government institutions, NGOs and society through analyses of the media, direct dialogue, participation in meetings and seminars etc.

#### C. Required qualifications, competences and experience:

##### Qualifications

- university degree (Master) in social sciences, tourism or regional management
- 5-7 years' professional experience, with at least 3 years' professional experience in tourism projects
- professional knowledge on Destination Management
- professional knowledge on tourism product development
- professional experience in collaboration with public administration at different levels in Albania
- exposure to tourism structures and actors outside Albania
- wide network in the tourism sector in Albania including MoTE and other donors in the field
- overview on agriculture and rural development issues in Albania
- confident and professional appearance towards different hierarchy levels of project partners
- strong organisational competence
- strong desire and ability to work in a team
- willingness to travel (abroad) regularly
- good knowledge and experience in rural areas of Albania (esp. regions of Dibra, Shkoder and / or Vlore)
- very good knowledge of English, ideally a knowledge of German
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

##### Contract conditions:

- Full time Employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: asap until 31.12.2022

Please forward your application until **17th of February 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de) including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**

##### Protection of personal data

If processing your expression of interest involves the recording and processing of personal data (such as your name, contact details and address and CV), such data will be processed pursuant to provisions of law no. 9887, dated 10.3.2008 "On protection of personal data", as amended. Your reply to this call and personal data requested are required for the purpose indicated in this vacancy and will be processed solely for that purpose by the programme



### Programme: Sustainable Development of the Rural Areas

Agriculture and rural development are of crucial with regard to socio-economic development in Albania as it accounts for 23% of the GDP and 42% of the overall employment. The majority of agri-cultural holdings is characterized by fragmented land use and small stock sizes. Significant structural deficits exist as well as weak advisory services and representation structures. In view of the aspired EU accession, a large proportion of farms and smaller processors are not sufficiently competitive. The consolidation of agriculture in the context of EU common agricultural policy and the current situation in rural areas require that the rural population has alternative income and employment opportunities. This is especially true for women and young people. Young people in particular leave the rural regions temporarily or completely in search of more attractive income opportunities. The strongest growth and employment impulses come from rural tourism. The further development of sustainable rural tourism depends heavily on the protection of natural and cultural landscapes and the sustainable exploitation of natural resources in rural areas. The environmental, economic and social potentials in rural areas are not yet sufficiently exploited to sustainably create and sustain diversified income and employment perspectives.

Starting in January 2019, a new BMZ-funded program on rural development will promote income opportunities in rural areas through increased competitiveness and diversification of agriculture, the valorization of biodiversity and the potential of rural tourism for employment-generating activities. The program will contribute to employment promotion in the agricultural sector and non-agricultural activities in rural areas by focusing on the principles and instruments of the EU's common agricultural policy for rural development. It promotes the participation of young people and women and thus contributes to gender equality. The program will apply an integrated approach on rural development with a focus on agriculture and rural tourism. It will consist of three interrelated fields of intervention (outputs):

- Output 1) Policy Advice for Rural Development
- Output 2) Promotion of Selected Value Chains (Cluster I: Tourism; Cluster II: Agriculture)
- Output 3) Improvement of Education & Training in Agriculture & Rural Tourism
- Output 4) Support to Agricultural Knowledge and Innovation System

The programme's duration is foreseen from 01/2019 – 12/2022.

**"Sustainable Development of the Rural Areas" programme, seeks the following staff:**  
Advisor – Agriculture (2 job positions)

#### A. Responsibilities

The advisor-agriculture is responsible for:

- implementing daily operational aspects of all issues related to the project in the following fields:
  - a) policy advice in agriculture with MARD (output 1)
  - b) promotion of selected agricultural value chains (output 2)
  - c) identification and coordination of education and training needs and measures in the selected agricultural value chains (output 3)
- strategy and policy advice in agriculture and rural development in the context of EU accession / Common Agricultural Policy for the Ministry of Agriculture
- implementation of agricultural-based value chain activities in rural development
- innovation and knowledge management
- maintaining of a good flow of communication and information between all involved institutions and counterparts and GIZ including regional projects
- ensuring that the contracting and spending of allocated funds run smoothly in his/her area of intervention.

The specific areas of responsibilities will be defined according to the capacities and experiences of both of the selected candidates.

The advisor - agriculture performs the following tasks:

#### B. Tasks

##### 1. Provision of advisory services

The advisor-agriculture

- gives substantial input to development and review of capacity development strategy in his fields of intervention
- establishes and maintains good communication and cooperation with partners on central, regional and local level
- identifies the needs of government institutions, private partners and NGOs as well as the project's beneficiaries
- advises partner institution(s) regarding clarification and identifying needs, developing concepts and strategies, and provides technical input in his field
- participates in identifying needs for external support and advice, drafts terms of reference for local and international consultants, works on policy recommendations and develops a strategic approach
- designs, prepares and conducts project activities and carries out other activities required for implementing outputs 1, 2 and 3 in the field of agriculture in close coordination with AMA Agriculture and the relevant Albanian partners based on needs
- participates in formulating project activities and helps synchronise the planning and budgeting system and counterparts
- is jointly responsible with the partner institution and AMA Agriculture for preparing, implementing and documenting training events, workshops, forums, and other project activities
- monitors the development, implementation and results of activities in his fields of intervention in close consultation with counterparts and AMA Agriculture
- support to program monitoring requirements.

##### 2. Communication and networking

The advisor-agriculture

- develops and maintains contact with all important stakeholders
- provides technical assistance to local and international experts
- ensures knowledge management: collects, processes and distributes relevant information, monitors communication and interaction between government institutions, NGOs and society through analyses of the media, direct dialogue, participation in meetings and seminars etc.

#### C. Required qualifications, competences and experience:

##### Qualifications

- university degree (Master) in agricultural sciences, agronomy, and/or rural development
- 5-7 years' professional experience, with at least 5 years' professional experience in the context of agriculture/rural development (preferably in the context of EU accession)
- good knowledge of the EU Common Agriculture Policy and pre-accession instrument IPARD
- experience in territorial approaches and participatory development
- practical experience and theoretical knowledge of value chain promotion
- confident and professional appearance towards different hierarchy levels of project partners
- strong managerial and organisational competence
- strong desire and ability to work in a team
- willingness to travel (abroad) regularly
- good knowledge and experience in rural areas of Albania
- very good knowledge of English, ideally a knowledge of German
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management
- good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the inter-net) and computer applications (e.g. MS Office).

##### Contract conditions:

- Full time Employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: asap until 31.12.2022

Please forward your application until **17th of February 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de) including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**

##### Protection of personal data

If processing your expression of interest involves the recording and processing of personal data (such as your name, contact details and address and CV), such data will be processed pursuant to provisions of law no. 9887, dated 10.3.2008 "On protection of personal data", as amended. Your reply to this call and personal data requested are required for the purpose indicated in this vacancy and will be processed solely for that purpose by the programme

# VIP


Suplement  
Pages

Emërkurë 30 Janar 2019 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Elisa Spiropali dhe Olta Xhaçka, kopje të njëra-tjetrës
- Pandeli Majko dhe Bashkim Fino, kryeministrat e krizave
- Nikolla dhe Kumburo, në të mirë e në të keq gjithmonë bashkë
- Majlinda Bregu heq kostumin zyrtar, kalon fundjavën në bregdet


S'po i kapim mat! Mesazhet private të Beatrixit me reperin shqiptar tregojnë se janë më shumë se shokë



Një kuartet i fuqishëm kuqe zi! Bebe kërkon bashkëpunim me Ritën, Avën dhe Dua Lipën



Nga Bieta Sulo te Rita Ora, ja të famshmit që s'do t'i njihni fëmijë



## Nostalgji për fëmijërinë, VIP-at hedhin fotot kur kanë qenë të vegjël

*Kush aktor e kush balerinë, si dukeshin  
njerëzit e mediës shumë vite më parë*

Nga Bieta Sulo te Rita Ora, ja të famshmit që s'do t'i njihni fëmijë

# Nostalgji për fëmijërinë, VIP-at hedhin fotot kur kanë qenë të vegjël

*Kush aktor e kush balerinë, si dukeshin njerëzit e medias shumë vite më parë*

Pamela Aliaj

**E**dhe pse vitet kalojnë, fëmijëria dhe kujtimet e saj mbeten në mendjen tonë për shumë kohë. Falë fotografive ama ne kujtojmë edhe imazhe që mbase na janë fshirë nga kujtesa. Nostalgjikë kanë nisur të jenë edhe VIP-at tanë. Ata, kaq shumë të komentuar dhe të përfolur për jetën e tyre personale, karrierën, famën, skandalet apo projektet e tyre televizive, sot do t'i shohim në një aspekt tjetër. Do t'ju sjellim një përmbledhje të fotove që vetë ata kanë postuar në 'Instagram' së fundmi por edhe më parë, kur kanë qenë të vegjël. Shohim fotografi të vjetra, disa prej tyre janë bardh e zi, por me shumë vlera. A ngjajnë ata me personin që janë sot?! A kanë ruajtur tiparet që kur kanë qenë të vegjël?! Ja disa prej fotove të VIP-ave fëmijë:

**RITA ORA**

Ajo është një nga këngëtaret me famë botërore që i bie botës rreth e qark me turnetë e saj dhe vetëm këtë vit ka udhëtuar në Kili, Beverly Hills, Las Vegas e Maldive. Rita Ora e tregoi me një mënyrë shumë origjinale sesa shumë e ka marrë malli për shtëpinë; këngëtarja postoi në Instagram një foto të vetën kur ishte fëmijë. Rita ishte djegur nga dielli gjatë pushimeve dhe e ëma, Vera, po e lyente me krem. Ngjashmëria e tyre, dallohet aty më qartë se kurdoherë tjetër; duket fare mirë se nga e ka marrë



Rita Ora

Rita bukurinë!. "Më ka marrë malli për mamën", shkruan ajo, këtu jam unë e djegur nga dielli gjatë pushimeve. Kalamaj, përdorni krem mbrojtës", ishte këshilla e saj. S'ka ndryshuar fare me ato kaçurrelat që fëmijë.

**OLTA GIXHARI**


Olta është sot një nga aktoret më seksi dhe më të komentuar në median rozë. Së fundmi ka postuar në rrjetet sociale një foto kur ishte një vogëlushe, por me siguri që askush nuk do e njihje nëse aktorja nuk zbulonte se ishte pikërisht ajo. "Unë në vitin 1989" shkru-

an Gixhari në postimin e saj. Dhe vërtet po ta shohim me kujdes shumë pak ngjashmëri ka me sensualen Olta që është ditët e sotme. **BIETA SULO**

Ajo është një ndër figurat më të dashura të ekranit. Ajo e cila shfaqet çdo pasdite shikuesit me emisionin e saj "Ftesë në pesë" në Top Channel. Mirëpo, askush nuk e dinte se Bieta Sulon e kemi parë shumë më herët në ekran, kur ajo ishte në moshë fare të vogël. Për "Tirana Post", Bieta ka konfirmuar se ka luajtur në filmin e njohur shqiptar "Djali elastik", ku ishte në



Enca Haxhia



Luana Vjollca



rolin e motrës 5-vjeçare të aktorit kryesor. "Jam unë 5-vjeç. Madje kam pasur edhe oferta të tjera pas këtij filmi, por s'më lanë prindërit se ishte lodhje për një fëmijë", - ka treguar moderatorja. **LUANA VJOLLCA**


Sfidën e 10 viteve ndryshime vetëm Luana Vjollca kishte mbetur pa e bërë. Ajo u akuzua se i trembej gjykimin të publikut prandaj dhe nuk kishte publikuar asnjë foto se si dukej vite më parë, të bëhej kështu pjesë e manisë më të fundit '10 vite më parë'. Ajo ka zbuluar disa momente kur ka qenë

imazhi kryesor i 'Digitalb' dhe vetëm 16 vjeç. "11 vite më parë, unë 16 vjeçe. Çfarë gjeta sot! Sekuenca nga spotet e shumta publicitare si imazhi kryesor i 'Digitalb'. Ps: 48 kile", ka shkruajtur ajo. Pra, shumë ndryshime edhe pse po të shohim një foto ku ka dalë fëmijë nuk gjejmë asnjë lidhje përveçse syve të saj me atë që është bërë sot. Ju e dalloni dot?

Më poshtë për nostalgji do ju risjellim dhe disa foto të VIP-ave të tjerë kur kanë qenë fëmijë. Shikoni ju e na thoni nëse arrini t'i njihni.




Bieta Sulo



Arbana Osmani



Çiljeta Xhilaga



Bleona Qerrelli



Olta Gixhari




Olta Gixhari

**E**dhe pse ka pak muaj që është bërë nënë, Adelina Tahiri ka kthyer trupin e saj ashtu siç dëshiron ta ketë. Vetëm para pesë muajve ka sjellë në jetë femijën e saj të parë, por këngëtarja i ka mahnitur të gjithë kur ka rikthyer shumë shpejt linjat e trupit. Ndërsa tani me anë të një fotografie të postuar ku shfaq barkun e saj të rrafshët para pasqyrës, ajo duket sikur të mos kishte lindur fare. Adelina së fundi ka treguar se ajo ka shtuar shumë në peshë gjatë shtatzënisë dhe kjo nuk i ka pëlqyer aspak. Tani në këtë superformë na ka mahnitur të gjithëve me format e saj. Të ketë pasur ndërhyrje vallë?



**Na habit të gjithë! Adelina Tahiri tregon barkun e zhveshur para pasqyrës**

**A**jo është një nga këngëtares shqiptare, të cilës i pëlqen shumë të eksperimentojë me pamjen e saj në këngët që publikon. Edhe kësaj radhe, Enca Haxhia ka eksperimentuar sërish me pamjen. Ky ndryshim vjen për shkak të projektit të më të ri. Në "Instagram"-in e saj Enca ka njoftuar se kënga më e re do të jetë baladë dhe titulli pritet të jetë "Baladë". Me anë të një fotoje të postuar në "Instagram", këngëtarja ka treguar për fansat pamjen e tërheqës. Postimi i Encës ka ngjallur mjaft reagime pozitive të fansave të saj. Kësaj radhe ka parapëlqyer të mos zhvishet për të tërhequr vëmendje. Duket se do të jetë interesante si këngë e saj e dytë në këtë zhanër në repertorin që ka.




**Harron të zhvishet Enca? Tjetër 'look' në këngën e saj**



**P**ara pak orësh këngëtarja me famë botërore, Bebe Rexha ka nisur një "iniciativë", kur përmes rrjetit social "Twitter" ka kërkuar një bashkëpunim mes këngëtareve shqiptare të suksesshme në botë. Ava Max është artistja e parë që ka reaguar, duke thënë se ky mund të jetë një version i ri i këngës "Lady Marmalade". E teksa pritej një reagim nga dyshja Rita ose Dua, është Dua Lipa ajo që ka shkruar në këtë postim të Bebes. "Hajde shqipee" duke bërë edhe shqiponjën me duar dhe i ka bashkangjitur një zemër. Do të jetë vërtetë një bashkëpunim super i suksesshëm dhe ne mezi presim që të realizohet.

**Një kuartet i fuqishëm kuq e zi! Bebe kërkon bashkëpunim me Ritën, Avën dhe Dua Lipën**



**V**erën e vitit të kaluar u përhap lajmi se këngëtarja Beatrix Ramosaj kishte nisur një romancë të re me reperin shqiptar që jeton në Londër, Escobars. U tha se ai kishte ardhur në Shqipëri për t'i kaluar pushimet me pranë Beatrixit dhe në postimet e tij në "Instastory" së bashku. Megjithatë të dyja palët e mohuan lidhjen, pak më parë Beatrix ka publikuar në "Instastory" mesazhet private me Escobars, që me siguri i kanë futur të gjithë në dyshime. Reperi i kishte dërguar asaj një meme, ku shkruante se veprimi i vajzës në fjalë i dukej i njëjtit me veprimin e Beatrixit. "Nëse ajo po të degjon kështu, mjaft gënjeve dhe vrapo. Ajo është gati për të të goditur". "Pse më duket si ty", i shkruan Escobars këngëtares, e cila ia ka kthyer duke qeshur "Aaa krejt". "Mu krahas fotos së bisedës, duke e shoqëruar emrin e reperit me një zemër të kuqe. Të jetë më tepër se shoqëri?"

**S'po i kapim mat! Mesazhet private të Beatrixit me reperin shqiptar tregojnë se janë më shumë se shokë**

# BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

**POLITIK**

## Elisa Spiropali dhe Olta Xhaçka, kopje të njëra-tjetrës

Elisa Spiropali është një nga prurjet e reja në kabinetin qeveritar "Rama 3", teksa ka marrë pozicionin e ministrit pa portofol për Marrëdhëniet me Parlamentin. Spiropali ka pasur një jetë aktive politike duke filluar angazhimin e saj publik me MIAFT dhe për të vazhduar pastaj në të gjitha shkallët e karrierës politike në radhët e PS-së. Ajo ka gjetur në kabinet një tjetër njohje të vjetër të saj, Olta Xhaçkën, e cila gjithashtu karrierën e saj të angazhimit publik e ka nisur me MIAFT dhe për të vazhduar në PS. Pra, dy ministre që kanë ndjekur thuajse të njëjtën trajektore në hapat e tyre politike. Por, ato duket se edhe sjelljen, edhe qëndrimin e kanë njësoj. Fotot e mëposhtme tregojnë pikërisht momente kur dy ministret qëndrojnë njësoj në sallë dhe duartrokasin po njësoj. Si për ironi edhe flokët i kanë të dyja njësoj, me kaçurrela, vetëm se njëra i mban zakonisht të lëshuara dhe tjetra të mbledhura.




## Pandeli Majko dhe Bashkim Fino, kryeministrat e krizave

Pandeli Majko dhe Bashkim Fino janë padyshim dy nga figurat më të vjetra dhe më popullore në radhët e socialistëve. Ata janë të dy anëtarë të Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë dhe që me njëri-tjetrin i lidh jo vetëm historia e gjatë në radhët e PS-së, por edhe fakti se kanë drejtuar qeverinë në momentet më delikate dhe krizash për vendin dhe kombin tonë. Bashkim Fino ka qenë kryeministër i Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar dhe ka drejtuar ekzekutivin në vitin e mbrapshtë '97, pasi vendi ishte përfshirë në krizë të thellë dhe të armatosur pas falimentimit të firmave piramidale. Nderkohë që Majko ka qenë kryeministër sa herë në PS ka pasur kriza të brendshme dhe në një rast i është dashur të qeverisë edhe kur i gjithë kombi shqiptar ishte përfshirë në një krizë nga e cila vareshin fatet e një pjese të tij, siç ishte lufta e Kosovës.



## Majlinda Bregu heq kostumin zyrtar, kalon fundjavën në bregdet

Që kur mori detyrën e re si sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal dhe u zhvendos në Sarajevë, demokratën Majlinda Bregu e kemi parë të postojë në rrjetet sociale foto nga ditët e saj të punës, që përfshijnë takime e mbledhje. Por, ndryshe nga ditët e tjera, ajo ka zgjedhur të postojë një foto nga përditshmëria e saj. E veshur sport, me kapele e syze, Bregu shfaqet buzë detit. Bashkë me të shfaqet edhe një djalë, me shumë gjasa e biri. Te dy duken sikur meditojnë. Në foton që e ka postuar në rrjetet sociale Majlinda thotë se është shumë tunduese të rrih buzë detit e të mos lahesh.



"Kjo puna bindese në dimër për të mos u la n'detin e verës, është uhhh", - shkruan ajo.

## Nikolla dhe Kumbaro, në të mirë e në të keq gjithmonë bashkë

Lindita Nikolla dhe Mirela Kumbaro janë dy nga ministret e sakri Lfikua nga ndryshimi që kryeministri Edi Rama i bëri qeverisë vetëm pak javë më parë. E në këtë njëse të sesionit të ri parlamentarë, ato e kanë gjetur veten të zbritur nga "maja e Olimpiti" për të filluar edhe një herë nga e para për të qenë deputete në ndihmë të qeverisë. Por, ironia e fatit ka dashur që të dyja ato të jenë jo vetëm në një komision parlamentar, por edhe të qëndrojnë të ulura afër në karrige ngjitur. Siç shihet edhe nga fotot, të dyja ato i kanë hequr "spaletat" dhe tashmë kanë nisur "zborin" në komisionet parlamentare, teksa mbajnë shënime dhe mbrojnë nismat e qeverisë.



## Këshilla

Për të shpenzuar çdo sekondë të jetës suaj me dobi, mësoni si ta bëni trurin të jetë arma më e fortë dhe vullnetin, motorin e palodhur të realizimit të dëshirave tuaja. "Ne jemi ajo ç'ka bëjmë vazhdimisht. Përsosmëria nuk është një akt, por një zakon", ka thënë Aristoteli shumë kohë më parë. Kështu, ditë pas dite, ne jemi ata që mund të ndërtojmë vetë suksesin tonë, por kjo kërkon angazhim, durim dhe vullnet. Për të mbetur te vullneti, ja cilat janë zakonet e provuara shkencërisht se do t'ju forcojnë atë.

## MEDITONI

Meditimi është mënyra më e shpejtë dhe më efektive për të rritur vullnetin. Duke medituar ju stërvitni trurin që të përqendrohet dhe t'i rezistojë nxitjes për të humbur kohë me hamendësime. Kërkimet tregojnë se praktikimi me nga 10 minuta për 2 deri në 3 ditë i jep trurit më tepër energji dhe ul stresin. Meditimi është thjesht praktika që jua sjell mendimet në të tashmen. Rreth 47 për qind e jetës sonë kalon duke reflektuar për të shkuarën, ose duke menduar rreth së ardhmes. Meditimi është pikërisht kjo dhuratë që e kthen mendjen tonë në të tashmen, largon çdo shpërqendrim dhe përqendrohet thjesht te frymëmarja. Nëse e keni mendjen të pastër dhe të përqendruar, atëherë synimet tuaja nuk do të eklipsohen nga asgjë.

## GLUKOZA SI SEKRET

Kur trupi konsumon ushqim, krijon një kimikat të njohur si glukoza, që qarkullon në trup nëpërmjet gjakut. Kjo është ajo çka truri e përdor si burim për të furnizuar mendimin, krijimin dhe vullnetin. Për të pasur sa më shumë përfshirje, sigurohuni që truri juaj të marrë mjaftueshëm glukozë që do të shndërrohet më pas në energji. Çdo ushqim që përmban kalori do t'ju japë glukozë, por jo çdo glukozë krijohet njëllëj. Ushqimet me sheqer ju japin glukozë që ka efekt afatshkurtër, por gjëja më e mirë që mund të bëni është të krijoni një balancë të qëndrueshme dhe afatgjatë. Po ashtu hani proteina, fruta të thata, fruta të freskëta dhe perime.

## FLINI MJAFTUESHËM

Kur nuk bëni gjumë të mirë, vullneti juaj bëhet shumë i dobët. Kur jeni të lodhur, qelizat e trurit nuk mund të thithin glukozën aq mirë, kjo do të thotë se ju nuk keni energji. Mos lejoni që kjo gjë t'ju errësojë gjykimin dhe t'ju mbajë larg synimeve tuaja në jetë. Flini mjaftueshëm për të pasur një vullnet celiku që do t'ju hapë dyert në plotësimin e ëndrrave dhe në arritjen e suksesit. Për të fjetur sa më mirë sigurohuni që dhoma juaj të



## Mungesë vullneti? Ja 10 mënyrat si mund ta forconi atë



jetë e errët, po ashtu mund të merrni një sy gjumë edhe gjatë ditës.

## STËRVITUNI

Të gjithë e dimë se stërvitja trupore bën mirë për shëndetin, por a e dini se bën mirë edhe për vullnetin? Kërkimet kanë zbuluar se ata që shkojnë në palestër ose bëjnë stërvitje fizike kanë kontroll më të lartë mbi trupin e tyre

dhe mund t'u rezistojnë më shumë tundimeve. Gjithashtu, sa më tepër të stërviteni, aq më në kontroll të emocioneve tuaja do të jeni. Do të pakësoni duhanin, alkoolin, kafeinën, do të kurseni më shumë para dhe do të hani më shëndetshëm. Të gjitha këto lidhen patjetër me forcimin e vullnetit, i cili do t'ju duhet shumë në jetë.



## BËJINI PUNËT ME RADHË

Mos prisni që të nisni shumë punë njëherësh dhe që vullneti juaj të jetë i mjaftueshëm për t'i bërë ato të gjitha menjëherë. Për të pasur sukses të madh në një detyrë që merrni përsipër, sigurohuni që të përqendroni shumë energji në atë punë. Pasi të përfundoni me sukses

një detyrë, kaloni te tjetra. Ky është sekret i përforcuar vullnetin.

## ARSYETONI

Një pjesë shumë e madhe e vendimeve tona gjatë ditës bëhen në mënyrë mekanike. Ne hamë, vishemi, shkojmë në punë në mënyrë automatike dhe pa e vrarë shumë mendjen për veprimet tona. Për të shmangur këtë ten-

dencë dhe për të bërë më tepër veprime të mira gjatë ditës, arsyetoni. Ndalojeni për një çast dhe vini në pyetje atë që po bëni, do të kuptoni se vullneti do t'ju forcohet.

## VEZHGOJENI VETEN

Analizojni me kujdes mendimet, veprimet dhe dëshirat tuaja. Brenda jush ekziston një person, të cilin ju doni ta përsosni. Merrni parasysh mundësitë dhe jepni vetes këtë shans. Filloni të veproni siç është mënyra më e mirë për veten tuaj të ardhshme, atë që dëshironi të bëheni.

## MBROHUNI

Kur studiuesit analizuan njerëz që dukeshin se kishin vullnet të hekurt, ata zbuluan se në fakt këta persona kishin një sekret për t'u qëndruar larg tundimeve që nuk sillnin asnjë të mirë. Ata nuk e vinin veten në situata që mund t'ia thyenin rutinën e shëndetshme. Jepini pak ndihmë vullnetit.

## GJENI FRYMËZIM

Nëse po kërkon për vullnet që do t'ju bëjë të fortë të arrini çdo gjë, atëherë duhet të kërkon edhe për frymëzim. Pa pasur një muzë që do t'ju shtyjë përpara, e keni të kotë që të ëndërroni për ndryshimin. Gjeni një motivim dhe ndiqeni atë.

## PLANIFIKONI ME DETAJE

Mendoni për një synim që dëshironi ta plotësoni. Pastaj filloni ta copëtoni atë në pjesë derisa të bëhet i mundshëm. Ndëroni me saktësi planin tuaj për ta arritur atë dhe do të shihni se nuk do të jetë aspak e vështirë. Duke ushtruar doza të vogla vullneti, do ta keni më të lehtë të arrini objektivin.

## ISHP, apel prindërve: Vaksinoni të vegjlit sa jeni në kohë

### Arrin në 41 numri i të prekurve nga fruthi, fëmijët nën 2 vjeç më të prekurit

Brenda muajit janar, numri i të prekurve nga fruthi në vendin tonë ka arritur në 41, duke shënuar kështu 11 raste të reja për 8 ditë. Këto të dhëna janë bërë publike ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik në një kohë që disa ditë më parë u shënuan një tjetër rast vdekjeje nga fruthi në QSUT. Sipas specialistes së këtij institucioni, deri më tani nuk ka asnjë rast në gjendje të rëndë. "11 raste të reja të fëmijëve të prekur me fruth janë shënuar vetëm përgjatë javës së fundit. Instituti i Shëndetit Publik konfirmon se tashmë numri i të prekurve përgjatë

# 41

#### TË PREKUR ME FRUTH

Numri i të prekurve nga fruthi në vendin tonë ka arritur në 41, duke shënuar kështu 11 raste të reja për 8 ditë. Këto të dhëna janë bërë publike ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik në një kohë që disa ditë më parë u shënuan një tjetër rast vdekjeje nga fruthi në QSUT.

muajit janar ka arritur në 41 persona. Kryesisht ata janë fëmijë të moshës nën 2 vjeç, të cilët nuk kanë aplikuar vaksinën e fruthit", - thekson ISHP. Deri më tani nuk ka asnjë rast të infektuar tek personat e rritur.

#### APELI I ISHP

Instituti i Shëndetit Pub-

lik u ka bërë thirrje të gjithë prindërve të vaksinonjë fëmijët e tyre sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit për grupet që janë më të rrezikuara. "Jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit që nuk janë vaksinuar ndaj fruthit apo nuk kanë marrë dy doza të vaksinës, duhet të vaksi-

nohen. Vaksinimi ndaj fruthit është mbrojtja më e mirë për parandaluar fruthin dhe komplikacionet që vijnë prej tij. Për shkak se kjo periudhë e vitit sjell rritje të numrit të rasteve të infeksioneve respiratore dhe gripit, bëhet akoma më i rëndësishëm vaksinimi, për



të parandaluar përhapjen e fruthit", - thekson Instituti i Shëndetit Publik.

#### MASAT

Masat e ndërmarra nga ISHP për mbrojtjen nga fruthi janë: izolimi në pavione të caktuara në spitale dhe vetizolimi për rastet ambulatorie, masa standarde

të kontrollit të infeksionit dhe ato të transmetimit nëpërmjet ajrit, përdorim i mjeteve të mbrojtjes personale, vaksinim i personelit shëndetësor, monitorim i gjendjes mbrojtëse të personelit ndaj fruthit, gjurmin dhe vaksinim brenda 72 orëve i kontakteve etj.

Kreu i KSSH, Kol Nikollaj: Ngjarjet lihen në harresë, të ndëshkohen fajtorët

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, 18 punonjëse të një fasonerie në qytetin e Durrësit janë helmuar e kanë përfunduar në urgjencë si pasojë e rrjedhjes së gazit. "Kanë shkuar për ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Durrës, 18 punëtorë të një robaqepësie në afërsi të mbikalimit të Fllakës. 11 prej tyre dolën nga spitali pasi morën ndihmën e parë, ndërsa 7 shtetase ndodhen jashtë rrezikut për jetën nën kujdesin e mjekëve.

Paraprakisht dyshohet se shkak ishte rrjedhja e gazrave në tubin e aspirimit, që nxjerr jashtë gazrat e kaldajës së hekurosjes. Grupi hetimor vijon punën për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", theksohet në deklaratën e policisë së Durrësit.

#### MASAT NDAJ SUBJEKTIT

Menjëherë pas ngjarjes, Inspektorati Shëndetësor, dega Durrës ka gjobitur dhe pezulluar aktivitetin e fasonerisë në të cilin u helmuan 18 punonjëset. "Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, dega rajonale Durrës, ngriti grupin e inspektimit, i cili shkoi menjëherë në subjekt dhe morri masë urgjente, Vendim i Ndërmjetëm, për pezullimin e aktivitetit të subjektit deri më datë 7 shkurt 2019 në pritje të përgjigjes së analizave nga ana e Drejtorisë Rajonale Shëndetësore Durrës si dhe masë administrative 500 000 lekë", thuhet në njoftimin e Inspektoratit Shëndetësor të Durrësit.

#### AKUZAT NGA SINDIKATA

I pyetur nga 'Gazeta Shqiptare', kreu i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Kol Nikollaj, tregon se kjo ngjarje nuk duhet të kalojë

# 18 punonjëse fasonerie në Durrës helmohen nga rrjedhja e gazit, reagon sindikata

Pezullohet aktiviteti i robaqepësisë, gjobë 500 mijë lekë



Kreu i KSSH, Kol Nikollaj

vetëm me një pezullim disa ditor dhe një gjobë, por thekson se duhet të merren masa më të repta. "Helmimi i 18 punonjësve në fasonerinë "Albistar" në Durrës nuk duhet të kalojë lehtë vetëm me një pezullim disaditor dhe një gjobë prej 500 mijë lekësh, siç vendosi Inspektorati Shëndetësor, pasi kemi të bëjmë me një ngjarje të rëndë e mbi të gjitha të përsëritur", thotë Nikollaj. Ky i fundit nuk lë pa përmendur edhe dy rastet e ngjashme të ndodhura një vit më parë, ku sipas tij fajtorët ende nuk janë ndëshkuar. "Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, ashtu si i gjithë opinioni publik, ka kërkuar të njihet edhe në

rastet paraardhëse (si në maj të 2018 dhe nëntor të 2018 kur u helmuan disa punonjëse në 2 fasoneri po në Durrës), se cilat ishin shkaqet e helmimit të punonjësve fasonere, por nuk i janë vendosur në depozicion përgjigjet e analizave nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror. Ato fasoneri sot vijojnë aktivitetin normalisht dhe as organet e rendit e ato të drejtësisë, nuk e kanë bërë mirëpunën e tyre. Ne jemi të bindur se shkak kryesor i helmimit si 2 rastet e mëparshme edhe sot është përdorimi i kimikateve, mastiçeve e bojërave ngjyrosëse të përdorura pa kriter, pa rregullshmëri dhe me cilësi të ulët", bën me dije kreu i

KSSH-së për 'GSH'. Nikollaj shton se Inspektorati i Punës dhe Përkujdesjes shoqërore duhet të vihet në lëvizje, pasi shumica e robaqepësisë nuk respektojnë kushtet e sigurisë teknike dhe ato të mbrojtjes së shëndetit në punë. "Dua t'ju kujtoj se një nga punonjëset fasonere ka qenë shtatzënë, e kjo është e rëndë, edhe për strukturat shëndetësore që nuk i ndjekin sa edhe si duhet gratë shtatzëna në frontet e punës. Inspektorati i Punës dhe Përkujdesjes shoqërore duhet të vihet në lëvizje, pasi shumica e robaqepësisë nuk respektojnë as minimalisht, kushtet e sigurisë teknike dhe ato të mbrojtjes së shëndetit në punë, përf-

#### KUSHTET

"Të gjithë e dimë shumë mirë se punonjëseve nuk u paguhen orët shtesë, nuk u paguhen ditë e diel, nuk kanë kontrata kolektive, marrin 26 mijë lekë në bankë dhe një pjesë të parave e kthejnë dorazi. Kemi denoncuar faktin se grave u kërkohet të mos mbeten shtatzënë se humbasin rendimentin, e kjo është nihiliste dhe një e vërtetë e trishtë", thotë Nikollaj.

atës. Ky i fundit shton se kompanitë fasonere nuk kanë pranë tyre infermierë dhe mjekë në përputhje me detyrimin ligjor dhe e cilëson këtë fakt si një shkelje të rëndë. "Punonjëset nuk kanë as kartela shëndetësore e nëse ndonjëra prej tyre është e prekur ose preket nga një sëmundje e rëndë, rrezikon të infektojë edhe kolegët për shkak të ambientit të mbyllur. Skllavërimi i punonjësve fasonere ka mbështetje politike, apo edhe mediatike, pasi shumë politikanë apo familjare të tyre, aty janë aksioner. Politika e di shumë mirë se shumë pronarë në këtë industri favorizojnë informalletin, shmangin detyrimet tatimore, disa madje nuk paguajnë as pagën minimale. Të gjithë e dimë shumë mirë se punonjëseve nuk u paguhen orët shtesë, nuk u paguhen ditë e diel, nuk kanë kontrata kolektive, marrin 26 mijë lekë në bankë dhe një pjesë të parave e kthejnë dorazi. Kemi denoncuar faktin se grave u kërkohet të mos mbeten shtatzënë se humbasin rendimentin, e kjo është nihiliste dhe një e vërtetë e trishtë. Fatkeqësisht shumë OJQ po marrin fonde nga donatorë brenda e jashtë vendit, nga vendet e BE dhe nga qeveria nëpërmjet fondeve të nxitjes së punësimit, për këtë problem, por nuk e ngrin kurrë zërin në formën dhe në mënyrën e duhur", thotë Nikollaj për 'Gazeta Shqiptare'.

120-VJETORI

# Homazh për shoqërinë "Bashkimi" dhe selinë që është në rrezik

Nga Dom Nikë Ukgjini

Për shkak të mospërfilljes dhe të lënies me qëllim në harresë, shoqëria "Bashkimi" e themeluar që plotë 120 vite më parë, e vlerësuar si një akademi kulturore njihet shumë pak në shoqërinë shqiptare.

Nën pushtimin e egër turk, shqiptarëve të shtypur, as në mesin e shek. XIX, kur perandoria po shkatërrohej, nuk i lejohehin institucione kulturore kombëtare, veç atyre fetare që gjendeshin nën patronazhin e Austro-Hungarisë. Në vijim të përpjekjeve për me i shërbye çështjes së zgjimit, bashkimit dhe çlirimit kombëtar, abati Preng Doçi mendoi për ta shfrytëzuar këtë mundësi për krijimin e një shoqërie kulturore e studimore për lëvizimin e gjuhës e kulturës shqiptare. Megjithatë ndodhej në kushte shumë të vështira politike për shkak të ndëshkimeve turke, e pamundësive e financiare, ai i hyri punës më zgjuarsis e guxim për të krijuar shoqërinë në shtëpinë e tij në Shkodër, në janar 1899, me pjesëmarrjen e Imzot Jak Sarreqi, Imzot Lazër Mjeda, klerikët: Dom Ndoc Nikaj, Atë Gjergj Fishta, Dom Dodë Koleci, Tomë Velaj etj. Në përshtatje me gjendjen pushtuese, për të mbuluar punën e saj të vërtetë kombëtare, shoqëria u paraqiti si fetare, prandaj si pjesëtarët të saj përmenden veç klerikë, megjithatë në gjirin e saj kishte edhe laikë, madje edhe intelektualë të besimit myslimane. Kur Valiu i Shkodrës e pyet Doçin, se çfarë janë ato mbledhje në shtëpinë e tij, ai do të përgjigjej: "Po zotni, kam thirrë disa priifta e jam tue plegneue do punë feje". Ishte e para herë, që në gjirin e Shqipërisë, ende nën zgjedhjen e egër turke të themelohet ballafaqë një shoqëri, për t'u marrë sistematikisht me lëvizimin e gjuhës shqipe. Dëshmitarët e kohës shprehen se themeluesi që meriton çmime e lavde të përjetshme që abati i Mirditës Preng Doçi, i cili gurin e përjetësisë të alfabetit e zhvillimit të kulturës e hodhi në 1899 në lagjen Sarreq të Shkodrës.

Alfabeti në fjalë me gjithë mungesat shkencore të kohës që mund t'i kishte në vete, ai qe fort praktik. Duke u nisur edhe nga praktika e gjermanëve, kroatëve etj., të cilët braktisën shkrimet gotike dhe për shkak të punës më të lehtë në shtypshkronja, shoqëria "Bashkimi" nuk i morën vetëm shkronjat e alfabetit të vjetër, apo vetëm ato të shoqërisë së Stambollit, por alfabetin e pastër latin.

Për të parën herë librat shqip do mund të shtypeshin gjithkund në shtypshkronjat brenda dhe jashtë vendit. Me këtë alfabet u shtypën librat shkollorë, kur shqipja nisi të përdorej zyrtarisht në



Shoqëria "Bashkimi"

## Shoqëria që bashkoi të krishterë e myslimane për gjuhën shqipe



shkollat e veriut, të organizuara atëherë nga perandoria Austro-hungareze. Edhe pse pas tri viteve, kulturës shqiptare iu shtua edhe alfabeti i Agimit (1901) nga Ndre Mjeda, shkrimtarët e njohur si: Fishta, Gurakuqi, Nikaj, Xanoni, Çajupi, Sciro, Peci, Fan Noli, Konica, Asdreni vazhdonin ta përdornin këtë alfabet. Revistat e asaj kohe, si Elçia (1891), Albania, (1897-1909), Kombi, Toska, Besa, La Nova Albania (Shqipëria e Re), etj., të cilat nuk shkruheshin me alfabetin e Frashërit, botoheshin gati të gjitha në alfabetin e "Bashkimit" edhe pse shumë shkrimtarë bënë modifikime të veta, sipas prirjeve të tyre. Më daljen në skenë të Kongresit të Manastirit në nëntor të vitit 1908, i dha zgjidhje një alfabeti të përbashkët, me germat latine, që do jetë themeli i një uniteti të alfabetit kombëtar, ku pëlqimin e dhanë 32 delegat nga Kongresi dhe jashtë tij.

Kjo akademi studimore, siç e quante Luigj Gurakuqi, është ngjitur, në kohë të vështirë e të rrezikshme, kohë droje, frike e shtrëngimi, ku vetëm një fjalë mund

//

"Ata ci t'i u apin  
niihme e t'i u  
bahen krah n'ket  
pune, i paste  
Shcypnia!"

të kthehej si faj i rëndë e kur dënime të ashpra e burgje të tmerrshme, do merrnin ata që guxonin të tregoheshin si mbrojtësit e dalëzotësit e gjuhës shqipe. Duke qenë frika reale, nga ndëshkimet e pushtuesit, shoqëria "Bashkimi" mbledhi rreth vetes një numër të kufizuar dijetarësh dhe idealistësh nga gjithë Shqipëria.

Në një memorandum të shoqërisë "Bashkimi" me dt. 20, gusht 1908, thuhej se: "Duke i dhënë besën njëri-tjetrit me punë të pareshur, me durim të madh e me bashkim vullnetesh, për gjatë 10 viteve të veprimtarisë, botuan 31 vepra të ndryshme studimore, për lëvizimin e gjallërimit e gjuhës dhe



Ish-Selia e shoqërisë "Bashkimi"



shkollave shqipe.

Më botimin e fjalorit "Fialuer i Rii i Shcypes", Shkodër, 9 janar 1908, si një pararojë e Kongresit të Manastirit, shoqëria Bashkimi i tregoj shqiptarëve se nuk punuam për veti, por për atdhe e gjuhën shqipe. Pas alfabetit të Kongresit të Manastirit, shoqëria "Bashkimi" u zotua se do ndjekin gjithçka që do lidhet me një bashkim të shqiptarëve, që përfshin gegë e toskë. Në përfundim të memorandumit të lart përmendur, thuhet: Ata ci t'i u apin niihme e t'i u bahen krah n' ket pune, i paste Shcypnia!

Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi", për vlerën që pati, u bë model dhe pikë referimi për hartuesit e më vonshëm të fjalorëve, si: Nobert Jokli (më1911e më 1923), Atë Fulvio Cordigano, (më1929 e më1934), Dom Nikollë Gazulli (më 1939 e më 1941), Atë Benedikt Dema, (më 1966), si dhe për studiuesit: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej etj. e deri të hartuesit e 'Fjalorit të Gjuhës Shqipe' të vitit 1954. Në shenjë nderimi ndaj kësaj ngjarje, Enti botues "Gjergj Fishta" bëri botimin anastatik të Fjalorit të 'Bashkimit', i pari botim mbas 110 vitesh në Shqipëri, duke i dhënë në dorë lexuesit të rinj një vlerë të çmuar gjuhësorë.

Por, ajo çfarë ka mbetur si trashëgimi me vlerë të rrallë, pos botimeve, është shtëpia e kësaj shoqërie në Shkodër e ndërtuar nga vet abati Doçi në vitin 1893. Në këtë kompleks unik për Shkodrën, u farkëtua guximi, trimëria, urtia dhe dënija kombëtare.

Meqenëse kjo ndërtesë është duke u degraduar, megjithatë përballoi rrebeshet e kohës, nisur nga vlera kulturore, historike e arkitekturore, Ministria e Kulturës në gusht të vitit 2018 e ka shpallur Monument Kulturore. Për ta shfrytëzuar dhe ruajtur në mënyrë më të plotë këtë pasuri kombëtare, është kërkuar që ky kompleks të shndërrohet në shtëpi muze, kush-tuar shoqërisë Bashkimi, abati Preng Doçi dhe atdhetarit Stef Curaniti.

Më këtë qëllim nga Kisha katolike e Shkodrës, është biseduar disa herë me Ministrinë e Kulturës dhe kryeministrinë për realizimin e kësaj ideje. Madje në këtë drejtim dhe Bashkia e Shkodrës ka bërë letrën zyrtare më 3 dhjetor 2018, drejtuar kryeministrisë dhe jemi në pritje të marrjes së një përgjigjeje pozitive. Me këtë veprim, do i rikthehej sadopak dinjiteti kësaj shoqërie, e cila në kohërat jetike për popullin tonë dhe kontribut të çmuar për ruajtjen e dinjitetit dhe identitetin e të gjithë shqiptarëve kudo që janë.

Opinion i Ditës

# Rithemelimi i Universitetit të Tiranës është imperativ!

Edmond Çata, PhD.

(vijon nga faqja 1)

1. Pse rithemelimi të UT ... shoqëria shqiptare, të shprehur për një universitet publik dhe arsim cilësor!

I dëgjuat ç'thonë për qeverinë eksponentët kryesorë të "Forumit për Autonomi" dhe të PD-së Valentin Duka, Mark Marku, Agron Gjekmarkaj, Artan Fuga? Qeveria ka paralizuar dhe po shkatëron universitetin! Po denigron pedagogët! Po tallet me studentët! Nuk i plotëson kërkesat e studentëve, nuk rri buxhetin, nuk përmirëson infrastrukturën! Është kundër universitetit të lirë dhe përbën rrezik për lirinë e universitetit!

I dëgjuat ç'thonë për universitetin Valentin Duka dhe Artan Fuga? Kanë mangësi! Por mos na kërkon të jenë Harvard apo Oxford! Jo universiteti kazermë, por të lirë dhe me demokraci universitare! Universiteti ka të meta dhe vese të rënda, por më mirë këto sesa diktatura. Shkenca, dija nuk bëhen me detyrim!

I dëgjuat çfarë thonë Duka, Fuga, Marku, Gjekmarkaj, apo Asambleja e UT, cilët janë përgjegjësit e gjendjes së mjeruar të universitetit dhe arsimit të lartë? Nuk janë fajtorë pedagogët! Është qeveria! Është çenimi i autonomisë dhe lirisë akademike të universitetit dhe pedagogëve! Janë VKM 777/781/783, Urdhrrat 183/184/185, dhe Ligji 80/2015!

I dëgjuat ç'thonë Duka, Fuga, Marku se kush i jep fund kësaj gjendjeje të mjeruar të universitetit dhe arsimit të lartë? Vetë universitetit! Vetëm pedagogët janë shpëtim! Edhe çështjen e plagjiaturave e zgjidhin vetë ata! Vetëm një model i ri universiteti! Vetëm anulimi i Ligjit 80/2015 të kundërshtuar që në fillim!

Studentët! Njerëz! Mjafton t'i mbani vëth në veshë këto deklarata për të kuptuar se pedagogët e UT nuk po ngrënë zërin sepse ju dogj barku për arsimin cilësor, për universitetin cilësor, për kërkesat dhe interesin e studentëve, për të mirën e publikut dhe shoqërisë, për autonominë e universitetit, për demin e ligjit të arsimit të lartë, apo ato që bëjnë apo nuk bëjnë Edi Rama! Në vend që drejtuesit dhe pedagogët e mbledhur tek "Liria" të bëjnë një "mea culpa," një katharsis të ndërgjegjës së tyre akademik-profesionale, shkatërruesit ndër vite të UT dhe të arsimit cilësor thanë: Do hyjmë në grevë!

Po, po! Ata mund të hyjnë në grevë! Por, jo për ata qindra studentë që qëndruan rrugëve me ditë të tëra jashtë në acar kundër sojit të Nikollës e kompani që Artan Fuga i thurte lëvdata post-mortem! Jo për arsimin dhe universitetin



cilësor! Nëse i futen grevës, kjo do bëhet vetëm për një qëllim: të mos vihen para përgjegjësisë për pa-përgjegjshmërinë profesionalo-shkencore si drejtues apo pedagogë, të mos iu dalë në dritë paafërsia akademiko-shkencore; të mos iu prishet rehatia personale!

2. Studentë vs. Qeveri vs. Pedagogë të UT

Në betejën studentë-qeveri jam me studentët për arsim cilësor, jo me pseudo-studentët me axhendë politike! Qeverisja e sotme, të gjitha qeveritë e mëparshme janë përgjegjës për gjendjen e arsimit të lartë dhe universitetit. Jam kritik ndaj qeverisë, sepse arsimi cilësor nuk është detyrë vetëm e drejtuesve dhe pedagogëve të universitetit. Për shkak të rëndësisë për individin, shoqërinë, ekonominë, qeverisjen dhe vetë shtetin, garantimi i cilësisë së universitetit dhe arsimit është detyrë edhe e qeverisë! Ç'bën ose nuk bën një qeveri për cilësinë, i bën gjërat tamam apo gjysmake, i çon në drejtimin e duhur apo të gabuar, janë gjithnjë arsye për kritikë ndaj çdo qeverie! Ca më shumë për atë të Ramës!

Por në betejën pedagogë-qeveri nuk mund të jem me shkatërruesit e universitetit! Drejtuesit dhe pedagogët e universitetit publik mbajnë një përgjegjësi akoma edhe më të madhe se qeveritë për gjendjen e sotme të arsimit të lartë dhe universitetit publik! Janë ata, që me vlerat dhe besimet, qëndrimet dhe veprimet e kanë varrosur cilësinë e arsimit dhe universitetit! Ata kanë qenë dhe mbeten jo zgjidhja, por burimi i problemit dhe së keqe! Ata, as kanë qenë, as nuk ka shans të jenë zgjidhja! Le më të garantojnë, arsimin cilësor!

Sot ata bëjnë fajtor qeverinë, ligjin e arsimit të lartë! Pa pikë turpi dhe ndershmërie pretendojnë se qeveria iu paska rëmbyer autonominë! Kjo është pandershmëria dhe gënjeshtria më e madhe! Ata "harrojnë" se një universitet e përmush misionin e vet jo për

shkak të "ligjit", por prej standardeve dhe praktikave të shëndosha profesionale, akademike dhe shkencore. Ata "harrojnë" se fakti se sa cilësor është një universitet dhe arsimi i lartë, më shumë se nga ligji përcaktohet nga seti i vlerave, besimeve, mendësisë, profesionalizmit dhe praktikave të rektorëve, dekanëve, shefave të departamenteve, pedagogëve të thjeshtë. Ata harrojnë se një universitet, sado të "pengohet" nga qeveria apo ligji i ditës, në esencën e vet, suksesin apo dështon nga ajo që bëjnë ose nuk bëjnë drejtuesit dhe pedagogët e tij. Kështu që përpara se të vrapojnë për të akuzuar qeverinë, apo shpallur si fajtor ligjin e arsimit të lartë, drejtuesit dhe pedagogët duhet të sqarojnë më parë se e kujt është përgjegjësia, e tyreja apo e qeverisë, për të gjitha "hyneret" që janë denoncuar publikisht nga studentët apo mediat për titujt akademikë, aktivitetin shkencor, aktivitetin si titullar dhe mësimdhënien:

I kujt është faji për lëshimin e titujve shkencorë me punime ose plagjiaturë ose pa kurrfarë vlerë shkencore? I qeverisë? I ligjit? Apo i Kuleve, Fugëve dhe të gjithë atyre që kanë bërë udhëheqësin shkencor, këshillat shkencorë dhe oponentët shkencorë? Kush ju ka "detyruar" ju, kush dhe si ua paska cenuar lirinë tuaj akademike, kur keni vlerësuar dizertacione apo punime shkencore dhe dhënë "pass" punimeve badiava? Kush ju ka detyruar ju të mos kundërshtoni fiktivitetin dhe falsitetin në rigoroze të profesionit dhe shkencor? Kush ju ka detyruar ju të firmosni pa pikë turpi procesverbale që lëshojnë titujt shkencorë të pamëritur? Nuk ju ka imponuar qeveria, as ligji, por jeni ju vetë që keni bërë një masakër të tillë. Ka qenë dëshira juaj, vullneti juaj, vlerat, besimet dhe mendësia juaj joprofesionale, joshkencore, klanore, klienteliste, nepotike, të turmës dhe të servilitë që ka vendosur!

I kujt është faji për mungesën ose pseudo-botimet tuaja shkencore? Për konferencat shkencore fiktive? Për pseudo-revistat shkencore që zgjidhni të "botoni"? Kush ju ka penguar apo cenuar në lirinë tuaj akademike dhe shkencore që të bëheni pjesë e komunitetit shkencor ndërkombëtar sipas fushës së ekspertizës individuale? Kush ju ka penguar ju dhe punimet tuaja të indeksohen dhe referencohen ndërkombëtarisht? Qeveria? Ligji? Apo mendësia, vlerat dhe besimet tuaja që pranojnë dhe praktikojnë mashtrimin dhe gënjeshtrenë si standard akademik? Paaftësia juaj!

I kujt është faji për abuzimin me studentin? Për kërkimin e parave për marrjen e provimeve? Për mosqarjen kokë as për hallet, as për interesat, as për nevojat e studentit? Mos mosdhënieve asnjëherë përgjigje me e-mail apo me gojë? Për mosparaqitjen në auditor për të kryer detyrën bazë tuajën, mësimdhënien? Është i qeverisë? I ligjit? Apo i juaji, që nga rektori e deri te pedagogu i thjeshtë? Që i lejoni vetes të mendoni dhe praktikoni bërjen "pallë ariu"?

I kujt është faji për rekrutimin e njerëzve pa kredencialet dhe eksperiencën e nevojshme profesionale, akademike dhe shkencore? Për pseudokriteret? Për praktikën nepotike, klanore, diskriminuese? Për mbushjen e universiteteve me anëtarët e partive, të interesave okulte, por jo me njerëzit e diplomuar në përëndim? Për ndëshkimin e atyre që kundërshtojnë praktikën e drejtuesve? Për abuzimin dhe vjedhjet me fondet? Për korrupsionin dhe mosndëshkimin? Është faji i qeverisë? I ligjit? Apo i drejtuesve nga rektorë e dekanë e deri te shefat e departamentit? Mos lëshoi vallë qeveria ndonjë urdhër? Mos vallë ju detyroi ligji? A ka ngritur zërin ndonjëherë ndonjëri prej jush?

Përse ju rektorë, dekanë, shefa departamentesh, pedagogë refuzoni t'i nënshtroheni vetingut aka-

demik, nëse vërtet jeni të "pastër"? Të aftë? Modeli për t'u ndjekur shembull? Përse refuzoni të ekzaminoheni nga një trupë vlerësuesish jashtë universitetit, jashtë qeverisë, ministrisë apo agjencive publike nëse jeni apo nuk jeni të denjë për të qenë staf i universitetit? Përse ia keni frikën qoftë edhe një VKM-je gjysmake si ajo Nr. 777 për identifikimin dhe ndëshkimin e rasteve me plagjiaturë? Përse, ndonëse janë bërë publike gjithë ato raste pandershmërie akademike, ju nuk i keni hequr titullin akujt, as Ervin Demos, as Hygerta Manastirliut, as Monika Kryemadhit e as kujtdo që publikisht i është demonstruar praktikimi i plagjiaturës? Përse nëpër universitetet publike ju nuk keni identifikuar asnjë person përgjegjës për gjendjen në arsimin e lartë dhe universitet, pavarësisht demonstrimeve të fuqishme studentore dhe provave publike? Përse asnjëri nga ju nuk dhënë dorëheqje? Përse asnjëri nga ju nuk del të pranojë gabimet dhe t'u kërkojë falje publike studentëve, familjeve, shoqërisë?

Prandaj zotërinj drejtues e pedagogë, pa iu dhënë përgjigje, përse kohë që në asnjë universitet publik nuk ka lëvizur asgjë, nuk është ndëshkuar asnjë, nuk ka asnjë autokritikë, nuk ka asnjë nuk ka dalë asnjëri t'u kërkojë falje studentëve, a nuk duhet pritur të bëhet kjo nga jashtë tyre?

Po zotërinj! Rektorë, dekanë, shefa departamentesh, pedagogë të thjeshtë! Me apo pa tesera partie. Mund të ulërin në kupë të qiellit që fajtori është qeveria, madje fajin mund t'ua vishni edhe vetë studentëve që kërkojnë veting akademik. Por, përpara se të bëni këtë, duhet t'u jepni përgjigje pyetjeve të mësipërme! Pa bërë një "mea culpa" publike, pa denoncuar vlerat dhe besimet e tuaja të mbrapshta, pa pranuar fajin dhe përgjegjësinë për praktikën dhe provat e bëra publike, për realitetin në universitet që nuk ka nevojë për koment, pa kërkuar vullnetarisht që t'i nënshtroheni vetingut akademik nga një trupë jashtë jush; ju të gjithë, drejtues dhe pedagogë të universiteteve publike nuk keni të drejtën morale as t'ia hidhni fajin qeverisë, as të pretendoni se jeni zgjidhja, as të pastroni arsimin e lartë dhe universitetin, as të garantoni arsimin cilësor. Ju patët 20 vjet në dispozicion për ta bërë këtë dhe nuk e bëtë. Në vend ta ngrinin të qiell, e zhytët arsimin e lartë dhe universitetin shtatë pashë në llucë. Dhe në vend të bëni një mea culpa, shpallni se do të hyni në grevë! Zgjidhja e vetme nuk jeni ju! Zgjidhja e vetme është rithemelimi edhe njëherë nga e para e Universitetit të Tiranës dhe e gjithë sistemit publik të arsimit të lartë!

Opinion *i* Ditës

# Shqipëria, "Eldorado" e koncesioneve dhe PPP-ve

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... Janë në nivele 3.7 miliardë euro (sa të ardhurat e buxhetit të shtetit tonë të një viti) dhe rreziku se mund të dalin me këpucë të kuqe (jo të suksesshme) apo edhe të dësh-tojnë tërësisht është i lartë. Deri tani, Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk merr nga kompanitë që kanë përfituar koncesionet dhe PPP-të asnjë raport mbi performancën dhe ecurinë e kontratave që kanë përfituar nga shteti shqiptar. Me ndryshimin e ligjit mbi koncesionet më 1 korrik të këtij viti, duhet të fillojë të marrë, por deri atëherë si kjo ministri dhe ajo e Energjetikës dhe e Infrastrukturas kanë të gjithë kohën e nevojshme të shikojnë batërdinë e interesave të dhunuara egër të të gjithë në shqiptarëve në koncesionet dhe PPP-të. Nuk dihet në asnjë moment se në ç'fazë të programeve të tyre të zhvillimit dhe të planeve të tyre të biznesit janë koncesionet dhe PPP-të e derisotme. Sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit, që riuaditoi në vitin 2016 Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, që duhej të kontrollonte kompanitë koncesionare të naftës (KLSH nuk futet dot në kompanitë private që kanë më pak se 50 për qind aksione të shtetit, e ndalon Kush-tetuta), si pasojë e ndryshimeve në planet e zhvillimit kohë mbas kohe, treguesit ekonomik-financiarë të arritur nga veprimtaria e koncesionarëve kanë pasur mospërputhje, krahasuar me parashikimet e miratuara në Planet Afatgjatë të Zhvillimit, si dhe Planet dhe Buxhetet e Punës vjetore. Po sipas KLSH, nëse nuk do të kishim ndryshim të planeve të zhvillimit, planeve të punës dhe buxhetit të kryer, shteti ynë do të kishte përfituar deri në fund të vitit 2014, përveç rentës minerare që ka marrë, edhe një shumë prej afro 305 milionë USD, si pjesë e fitimit nga prodhimi i naftës. Planet janë ndryshuar sipas qejfeve të kompanive koncesionare, në dhunim të shumë kushteve të kontratave, që të mund të deklaroni daljen me humbje për vite me radhë. Askush nuk e ka qarë kohën nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturas, apo edhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, për të kërkuar llogari pse nuk zbatohen planet e miratuara. Investimet, pamundë-



sia e kontrollit të zbatimit të pro-jekteve koncesionare nga strukturat përgjegjëse të shtetit tonë kanë çuar në një "Eldorado" (vend për-rallor, parajsë) të kompanive koncesionare gjatë viteve 2004-2014 dhe më tej të kompanive me kontrata Partneritet Publik-Privat (PPP). Prezantimi i investimeve dhe vlera e deklaruar zyrtarisht e tyre, pa asnjë kontroll verifikues nga ana e dy ministrive që duhej ta kishin bërë këtë verifikim, ka garantuar jo vetëm pozitën e privilegjuar të investuesit të huaj të ardhur shpesh nga parasjats fiskale, por ka përbërë edhe "Leven e Arkimedit" me anë të së cilës janë injoruar, madje edhe cenuar, në disa raste rëndë interesat e ekonomisë kombëtare të shqiptarëve. Kjo ka ndodhur në një numër investimesh koncesionare në energjetikë, në shumicën e HEC-ve private dhe në shfrytëzimin e naftës. Tri vite më parë, qeveria vendosi më në fund të hartojë një Regjistr të Koncesioneve. Ende, edhe pse

kanë kaluar 1300 ditë, ky regjistr nuk është asgjëkund dhe asnjë në qeveri nuk di të thotë se kur ky instrument i rëndësishëm për një qeverisje të mirë të pasurive publike do të jetë aktiv dhe në dispozicion të palëve të interesuara, qytetarëve, shoqërisë civile, donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Mungesa e kompanive të njohura ndërkombëtare (më në fund këto kohë kemi kompaninë "Shell") bën kontrast me fillimet e tranzicionit tonë, kur në ekonominë shqiptare u ofruan kompanitë mëdha të njohura ndërkombëtarisht, me emër dhe autoritet të padiskutueshëm. Pastaj i larguan oligarkët tanë dhe zyrtarët e lartë të kapur të qeverive. Në 15 vitet e fundit, gjendja ndryshoi në favor të kompanive të reja, që krijohen posaçërisht për një veprimtari koncesionare të caktuar, një pjesë e mirë të regjistruara në parasjats fiskale. Këto kompani kanë qenë të zonjat vetëm të shfrytëzonin barbarisht burimet tona natyrore dhe të fshih-

nin me shumë mjeshteri qindra milionë euro dhe dollarë detyrime për t'i paguar shtetit shqiptar. Kompanitë vendëse pa asnjë eksperiencë në fusha të caktuara për shërbimet publike (për shembull në mjekësi), janë krijuar qëllimisht nga oligarkët me influencë në qeveri, për të marrë kontrata koncesionare të tipit PPP, duke u futur me paturpësi dhe pa asnjë mbajtje përgjegjësie nga ata zyrtarë publikë që i miratuan këto kontrata, në xhepat e ardhme të qytetarëve të këtij vendi, që "kusuret" e këtyre kontratave në skalione qindra milionë euro do të duhet t'i paguajnë nga taksat e tyre për 10-15 vitet e ardhshme. Kjo Eldorado koncesionesh e PPP-ësh duhet të marrë fund njëherë e mirë. Ministria e re e Energjetikës po bën mirë që po kontrollon rreptë HEC-et e vogla të padobishme apo të dështuara, por do bëjë akoma dhe më mirë të shtrijë kontrollin në të gjitha 108 kontratat koncesionare në fushën e energjetikës dhe infrastrukturas.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Të lindurit e kësaj shenje duhet të tregohen më të kujdesshëm me shëndetin. Përpiquni të forconi imunitetin duke ndjekur një regjim të shëndetshëm ushqimor. Gjени një mënyrë për të përbushur premtimet. Mos eksperimentoni në dashuri.

**DEMI**  
Dita e sotme do t'ju kalojë pa e kuptuar. Puna, jeta personale dhe financat do të kërkojnë vëmendje të veçantë. Është e rëndësishme të mos lini asnjë detyrë pa përbushur. Në mbrëmje, lini bizneset mënjanë dhe përkushtojuni familjes.

**BINJAKET**  
Shumë Binjakë do të përfshihen në aktivitete sportive. Mund të merrni pjesë në një konkurs ose lojë. Sjellja juaj do të tërheqë vëmendjen e dikujt. Në mbrëmje përpiquni të relaksoheni, bëni një shëtitje ose joga.

**GAFORJA**  
Shmangni personat që iu afrohen vetëm për interes. Rrezikoni që të mos përbushni qëllimin tuaj sot. Nëse dëshironi që ëndrra juaj të realizohet, veproni me kujdes. Mos përhapni informacione false, pasi nuk do të mirëpritën.

**LUANI**  
Për Luanët kjo ditë mund të shënojë nisjen e një ndryshimi të madh. Disa do të zgjedhin një rrugë të re profesionale, disa mund të reformojnë jetën personale. Mos harroni marrëdhëniet tuaja aktuale. Do të kaloni një mbrëmje të qetë.

**VIRGJERESHA**  
Disa Virgjërësha sugjerohen që të kryejnë ushtrime fizike, pasi janë shumë të rëndësishme për shëndetin tuaj. Gjithashtu, duhet patjetër të gjeni kohë për të pushuar. Nëse nuk mund të merrni një ditë pushim, punoni ngadalë dhe pa u nervozuar. Në jetën personale mund të përballeni me disa telashe.

**PESHORJA**  
Gjatë kësaj të mërkure, të lindurit e kësaj shenje nuk do të tregojnë interes për disa çështje në punë. Bëni mirë ta ndani punën me një koleg. Në mbrëmje mund të merrni një lajm që do të ndikojë në të ardhmen tuaj.

**AKREPI**  
Akreptë ka gjasa të përfshihen në thashetheme. Mos i besoni gjithçka që thuhet. Do të kaloni një ditë të vështirë. Megjithatë, përpiquni t'i merrni gjërat me qetësi, përndryshe do të ndiheni shumë të lodhur psikologjikisht.

**SHIGJETARI**  
Duhet të jeni vetvetja edhe në situata të vështira dhe konfuze. Mos hezitoni të kërkeni ndihmë nga dikush që i besoni plotësisht. Nuk është dita e duhur për të bërë blerje apo për të ndërmarrë udhëtime të gjata.

**BRICJAPI**  
Do të mendoni pozitivisht gjatë ditës së sotme. Kjo do t'ju ndihmojë të shënoni sukses në biznes, dashuri dhe partneritet. Në fund të ditës mund të përballeni me një konflikt në familje.

**UJORI**  
Ujorët do të kenë nevojë për ndihmën e miqve. Sot mund të shpenzoni shumë dhe do t'ju duhen para më shumë se buxheti juaj. Përveç kësaj, nuk do të keni asnjë vështirësi. Shoqëria, dashuria dhe familja do të jenë në drejtimin e duhur.

**PESHQIT**  
Sot do të jetë dita juaj me fat. Do të ndiheni të kënaqur me arritjet tuaja në punë. Gjithashtu, do të zhvilloni një bisedë shumë të këndshme me partnerin/partneren tuaj, e cila do të mbetet gjatë në kujtesën tuaj.

**BLUE TOOTH**  
THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA

te rejat nga jeta

**ipave**

005 10 1000 1000

**KËRKON TË LUAJË ME KOSOVËN**

Loret Sadiku është një nga emrat e shumë që janë laktuar për të veshur fanellën kuqezi. Më herët mesfushori që aktivizohet me Kasimpasha në Turqi, kishte përfaqësuar Suedinë e 21-vjeçarëve. Por pak kohë përpara se të konkretizohet ky bashkim, Sadiku e



**Pretendon se i kanë falsifikuar firmën, Sadiku padit FSHF-në**

rimendoj situatën dhe nuk u paraqit më në grumbullimin kuqezi. Prishtinai u 27-vjeçar tashmë kërkon të luajë me Kosovën, dëshirë që e pati shprehur që kur shteti më i ri i Europës nuk ishte

ende pjesë e FIFA-s dhe UEFA-s. Tashmë Sadiku ka pajtuar një avokat me pretendimin se Federata Shqiptare e Futbollit i ka falsifikuar firmën dhe shpreson që shpejt të jetë pjesë e urdhrave të Bernar

Shaland. Në një prononcim për gazetën "Zëri", është vetë kryetari i FFK-së, Agim Ademi, i cili foli për çështjen në fjalë: "Dëshira e Loret Sadikut është që të aktivizohet me Kosovën. Ai e ka angazhuar një avokat në FIFA në mënyrë që ta fitojë të drejtën për të luajtur me Kosovën" - u shpreh Ademi.

Mesfushori rrëfen karrierën e tij. Shpreson që si trajner të ketë të njëjtin sukses si lojtar



Jeton Selimi

Ervin Bulku ka qenë një nga lojtarët më karizmatikë në fushat e blerta. Mesfushori tiranasi, që pjesën më të madhe të karrierës e ka kaluar të bardheblutë e kryeqytetit, tregon për emisionin "Adrenalinë" në "IN Tv" eksperiencën e tij si lojtar, atë aktualen si ndihmëstrajner i Kombëtares, tekta shpreson që si trajner të ketë të njëjtin sukses që ka patur dhe si futbollist.

**UKRAINA**

"Pa diskutim ka qenë i vështirë. Nuk është si sot që lojtarët kanë menaxherë që po punojnë që futbollistët shqiptarë t'i çojnë në ekipe dhe kampionate më të forta. Unë ika drejt Ukrainës dhe qëndrova një muaj në fazë përgatitore. Kjo ndodhi deri në momentin që trajneri dhe drejtuesit vendosën që të bëhem pjesë e skuadrës së Krivbas."

**MOMENTI MË I BUKUR**

"Ka shumë momente, por më kulminanti ka qenë ai kur kemi shkuar me Kombëtaren në Francë 2016. Ai është kulmi për një futbollist shqiptar. Nuk arrijtë më të madhe se ajo për një

**Bulku: Panuçin do ta shohim pas muajit mars**

*Ndihmësi i italianit bën krahasimin me De Biazin*



lojtar". Trajneri më i mirë "Është e vështirë t'i ndaj trajnerët, me të gjithë kam pasur dhe vazhdoj të ruaj marrëdhënie të mira. Komunikoj me ta gjithë kohës".

**KUJTIMI MË I KEQ**

"Për çdo lojtar moment i keq është atëherë kur ke një kohë të gjatë dhe nuk je në fushën e lojës, ndonjë dëmtim i gjatë, por unë fatmirësisht nuk kam pasur

shkëputje të gjata. Kam qëndruar jashtë për periudha 2-3 javore. Kam pasur ndonjë tërheqje dhe jo probleme me ndonjë ligament të gjurit, që është fatal dhe të lë 6 muaj ose më gjatë jashtë".

**KOMUNIKIMI**

"Nuk them dot vetëm një. Kam luajtur shumë gjatë me ekipin kombëtar dhe duket sikur i diferencoj. Në Kombëtare, aty kuptohemi të gjithë, pasi japim maksimumin për fanellën. Probleme me ndonjë? Jo, asnjëherë. Kemi pasur marrëdhënie të mira, dhe vazhdoj e mbaj kontakte me ta. Është normale, që mund të kesh ndonjëherë zënka momenti në ekip, sepse futboli i tillë është".

**MË SHAKAXHIU**

"Salihi, Osmani dhe Bogdani, në kohën kur unë isha pjesë e skuadrës".

**PANUÇI APO DE BIAZI?**

"Për Panuçin është akoma herët që të flasim, pasi këtë periudhë ai ka njohur lojtarët dhe tani e ka një ide të qartë për ta. Mendoj se kur ishte De Biaz, sepse unë kam qenë edhe lojtar edhe ndihmës i tij, shumica e lojtarëve kanë qenë në formë shumë të mirë dhe aktivizoheshin nëpër skuadrat e tyre. U bashkuan shumë gjëra, një zinxhir i gjatë që të arrinin atë sukses. Pa diskutim që trajneri dhe të gjithë patën ndikimin e vet atë sukses. Nëse në mars kur të nisim eliminoret, lojtarët do të jenë në formë, mund të ecim mirë".

**POZICIONI**

"Shumicën e kohës kam luajtur mesfushor para mbrojtjes, ndaj ai është pozicioni që më pëlqente më shumë. Mbrojtjes i dhatë ose qendërmbrojtës jam aktivizuar kur ka pasur nevojë trajneri dhe për nevojë të skuadrës".

**SUPERLIGA**

"Mendoj se kampionati shqiptar vjen në rritje çdo vit, pasi edhe terrenet, edhe stadiumet nuk janë më si përpara. Kur për mirësohen kushtet, mendoj se edhe nive-

**GJERMANI I REALIT**

**Kros: Jashtë garës për titull, kemi probleme**

Në një intervistë të dhënë për të përditshmes berlineze "Die Welt", gjermani Toni Kroos ka pranuar se Real i Madridit nuk e ka më kampionat një prioritet të tijin. Në La Liga, Real i Madridit është i treti me 10 pikë diferencë ndaj Barcelonës së vendit të parë, ndaj shanset për t'u shpallur kampionë në Spanjë janë vërtet minimale, ndaj synimet janë zhvendosur te Kupa e Mbretit dhe Liga e Kampioneve. "Jemi ende kompetitivë në këto dy veprimtari dhe jemi përqendruar vetëm aty. Nuk ka arsye për t'u dorëzuar, jemi ende në gjendje për të fituar trofe", thekson lojtari i përfaqësueses gjermane. "Siç duket kemi probleme dhe kemi lënë shumë pikë gjatë fazës së parë në kampionat, sepse kemi gabuar shumë. Sidoqoftë me kemi një ekip të shkëlqyer dhe sukseset e viteve të fundit na mbushin me vetëbesim. Nuk kemi asnjë të drejtë për t'u rrëzuar tani", tha ndër të tjera Toni Kroos.

li rritet. Titulli? Është ende herët për të folur, sepse ka edhe dy faza për të luajtur, por mendoj se do të jetë një kampionat shumë i fortë. Do jetë ndryshe nga vitet e mëparshme, kur Skënderbeu apo Tirana shkëputeshin shumë. Këtë kampionat do ketë konkurrencë deri në fund. Aty do ndahet edhe titulli".

**IDHULLI**

"Çdo lojtar dëshiron të arrijë majat, por si një lojtar shqiptar mendoj se jam i kënaqur me atë çka kam arritur. Normale është që çdo njeri do sa më shumë, nuk kënaqet me aq. Në të shkuarën idhulli im ka qenë Marko Van Basten".

**DISIPLINA**

"Nëse kam arritur deri këtu në karrierë, ka qenë prej disiplinës. E kam zbatuar me përpikëri, një disiplinë të hekurit, ndaj edhe kam pasur një karrierë të gjatë. Nëse mban regjim dhe stërvitesh mirë, edhe ke pak dëmtime, siç thashë më parë". Mesazhi "Të gjithë ata femijë, të rinj, që mundohen dhe japin maksimumin, stërviten çdo ditë dhe sakrifikojnë, një ditë do shpërblehen për atë mund dhe djersë që do derdhen". E ardhmja "Nuk mund të bësh plane, nuk është mirë t'i bëj. Nuk diskutohet që afër futbollit. Shpresoj të kem të njëjtin sukses edhe tani, sikurse gjatë kohës që kam luajtur futboll".

**KUNDËR RRYMËS**

**Alegri: Juvja favorite në Champions? Çmenduri!**

Masimiliano Alegri është fokusuar te ndeshja e radhëskundër Atalantës, ndonëse në konferencën e fundit për shtyp, gazetarët këmbëngulën dhe te objektivat bardhezi. Shumë specialistë e kanë etiketuar ekipin torinez si favorit për të triumfuar në finalen e madhe të Madridit në këtë sezon, por Alegri nuk është aspak dakord, madje kërkon t'i minizojë në maksimum këta zëra, që natyrisht mund të shkaktojnë eufori dhe shpërqendrim. Sipas tij, fillimisht duhet të mendohet vetëm për Atletikon e Madridit, që është një rival vërtet i fortë. "Nuk është e shkuar askund se Juventusit është favorit absolut për të shkuar në finale. Është çmenduri ta mendosh këtë. Nëse jemi të mirë do të ecim, por Atletiko nuk është e lehtë. Kemi luajtur 2 finale në këtë vit. Nëse kamionat është ndryshe, mund të humbasësh, ndërsa në Europë nuk lejon gabimet", tha ndër të tjera trajneri bardhezi.




**Ndodh në Emiratet e Bashkuara Arabe**

**U eliminuan, tifozët gjuajnë me shapka lojtarët kundërshtarë**

Vetëm një hap larg finaleve të Kupës së Azisë, Emiratet e Bashkuara Arabe të drejtuara nga Alberto Zakeroni kanë humbur me rezultatin e thellë 4-0 ndaj Katarit. Skuadra e drejtuar nga Sañez konfirmohet befasia e turneut dhe shfaq formë të mirë në prag të Botërorit 2020, që do të zhvillohet pikërisht në Katar. Pasi mposhti Irakun dhe Korenë e Jugut, Katar eliminon dhe të zotët e shtëpisë duke shkuar në finale, ku do të ndeshet me Japoninë që eliminoi Iranin. Ndeshja u zhbllokua nga goli i Khukhis në minutën e 22-të, ndërsa dyfishin me Ali në fund të pjesës së parë. Pas dyfishimit nga katarjotët, ndodh dhe episodi i shëmtuar me protagonistë tifozët vendës, që gjuajnë me shishe dhe shapka lojtarët që po gëzojnë golin. Në pjesën e dytë, Katar shënon dhe dy gola të tjerë, por kësaj here fatmirësisht tifozët nuk kanë më shapka për të hedhur.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Henri që qe piktor.
6. Janë si këshijtella
12. Maiden që këndojnë.
13. Janë enë benzine
14. Eshhtë melodramë.
17. Eshhtë vegël.
18. Gjysmë sterile.
20. Janë mallkime shkishëruese.
22. Ishte zogu simbol i Jezu Krishtit.
24. Ai dhe ajo.
27. Janë sëmundjet që përhapen.
29. Gjëja e romakëve.
30. Shenjtorja që iu pre koka.
31. Camus që shkroi I huaji.
34. Fillojnë ilustrimet.
36. Dieta pa ekstreme.
37. Ndërmarrje Autonome Sarandë.
40. Mund të jenë postare.
42. Ekstreme në sirtar.

43. I mungon asaj që i ka kaluar koha.
46. Një ekip... anglez
47. Ente Ekonomike Rajonale.
48. Një llahtar.
51. Transporton edhe maune në det.
52. Quinn aktor.

**VERTIKAL**

1. Fillojnë mirë.
2. Nuk i tregohen babait.
3. Në hyrje të tokës.
4. Gruaja e dytë e Atamantit.
5. Merren në bllok
6. Kalimi në kufij
7. Qe burri i parë.
8. Frolich e Marlene Dietrich.
9. Kanë aderuar në parti.
10. Shteti pa shi.
11. Një pjesë e etiketës.
13. Një pellg.
15. Janë kundërshtarë në gjyq.
16. Eshhtë pije e jona.
18. Luhen me 1. X, 2
19. Mbretëria e Pirros.
21. Braktisi Didonën.
23. Emri tjetër i Esaut.
25. Një pjesë e territorit.
26. Një copë për xhepa.
28. Janë patriotë të Chopin.
32. Ray aktor.
33. Mund të jetë solemn
35. Alessandro, bomber te Juventus.
38. Ylli i Londrës
39. Sapo fillojnë
40. Emri i Mondrian.
41. Kufizojnë katete.
42. Lindi Isakun.
44. Thurman aktore.
45. Në mes të Tommy dhe Jones aktor
49. Harris aktor.
50. Një rajon kur s'është ajo.

**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Gardner që qe aktore.
4. Në krye të bashkisë .
6. Emër vajze.
9. Fillojnë pushimet.
10. Janë si biskota
14. Të fundit në ditar.
15. Janë trupa pa kënde.
16. Fillojnë notimin.
17. Në radhë të parë.
18. Pak latinisht.
20. Eshhtë gjendje të fikti.
23. Eshhtë vërtet e mërzihsme.
24. Një mund të jetë fetar
26. Gjysma e sallës.
27. Pak dorështrënguar.
28. Rastisin në krye.
29. Një... dollar.
30. Një pjesë e etiketës.
31. Skuadra e Moratti-t.
32. Ego... ime.

**VERTIKAL**


33. Eshhtë sport me stil të lirë.
35. Ekstreme ekstreme.
36. Një mbishkrim në kryq.
39. Kanë bërë piktoreskë të tillë.
41. Një vendës autokton.
42. Argento aktore.
44. Një Behar, aktor komik.
46. Ka tre muaj.
48. Një fjalë si asnjëherë .
50. Në krye të armiqve.
51. Janë legjenda.
52. Flet për të bukurën.

**VERTIKAL**


1. Një thirrje me emra.
2. Vulosen të parat
3. Këndojnë me zë të trashë të tillë
4. Një mund të jetë armë.
5. Mbyllin fushatat
6. Një grimcë me bërthamë.
7. Dacia shkrimtare
8. Eshhtë lloj papagalli
10. Fillojnë afrimin
11. Kapet një me fishkëllimë.
12. Mbahet në mblehdje.
13. Ekberg aktore.
15. Janë zburkurre.
19. Janë diletantë .
21. Janë zonat e kufizuara
22. Janë tallësit.
25. Fillojnë temën
26. Një gjë.
32. Bëhen për të mirë
34. Eshhtë shtet aziatik.
37. Inicialet e Nolte aktor.
38. Shkruhet në janar.
40. Teliti regjisor.
43. Një pjesë e dramës.
45. Rastet pa set.
46. Inicialet e Penn aktor.
47. Të fundit në studim.
49. Kufijtë e rritjes.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

SEVENUP STEFFI  
AMIN KAPITALI  
RITET RELE AM  
ALET FILOKETE AM  
HE KAMIKAZE K  
PROTOKOLLA RE  
KATAMARANI OT  
IR COLIN ROMY  
TEMAE IBORIS  
ANITAE MILANO  
RANVIT MJEAN  
ETILENFRATI

**FJALËKRYQI (2)**

BAOBA B PEDANAT  
IR PERIPATE TI KE  
APEL RIVBNAR  
VELPIRAMIDAM  
AR KOLORITIT LE  
PROTAGONISTE T  
KANTATATKATE  
ARIELTATURT  
SALATI KITS  
PAE STPIRATI  
IRRMITBANORET  
KRATERE TGTIRI

**SUDOKU**

		9					7	
2		1	9					5
6		8	4			9		
						7	8	
			5		8			
		6			4	1		
			7	3				
			2		6		3	
		7		8		4	6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	8	2	6	7	3	1	9	4
6	7	1	5	9	4	2	8	3
3	4	9	8	1	2	5	6	7
7	5	4	2	8	6	3	1	9
8	9	6	7	3	1	4	5	2
1	2	3	4	5	9	6	7	8
2	1	5	9	4	8	7	3	6
4	3	8	1	6	7	9	2	5
9	6	7	3	2	5	8	4	1

*Argëtim filozofik*

-Nuk kërkoi kompensim rilindjen në Qiell , por kërkoi të mirën e njerëzve , kërkoi të ridrejtoj ata që kanë humbur dritën e tyre , ata që jetojnë në errësirë dhe të zhduk nga bota të gjitha dhimbjet e vuajtjet .

-Ai që vesh robën e verdhë pa u pastruar , pa fituar dominimin e vetes e pakërkuar të vërtetën , është i padenjë për ta veshur atë .

-Mposht njëmijë herë , njëmijë burra në betejë : vetëm ai që mund veten është luftëtari më i madh .

*Thënie të mençura*

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

19V	1	A	18P	7	E	13	2		19	4	11	16	1	A	Z	O	V	E	T	N	A		B	A		
1	6	1		15	7	9	12	2	12	2		11		Z	A	G	A	R		R	A		M	B	A	S
3	2		10	7	6	2	4	11	2	16			1	I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I		
7		12	4	11	7	6	13	7		3	3	18		L	C	A	S	U	S	B	E	L	L	I		
6	7	2		11	2	2		4		1	6	3		M	A	R	T	I	N	A		E	N	K	E	
	18	1	6	1	11	1				1	3	4		E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N		
18			7		1		16	2	8	4	13	1		T	I	M	E	T	I	P	I		A	F	E	
6	1	5	3	7		11	7	13	2	6	4			A	M	O	R	F		R	A		T	A	R	
4	8	7		8	7		5	3	7		3	3		L	O	N	Z	E	T	A		F	A	Z	A	
19		15	2	7	13	1		7	13	3		4		E	R	I	C	C	E	V	O	N	E			
1	6	2	1	13	7	3		6		6	1	18		T	E	A	M		A	L	B	A	N	E	T	
3	7	6	6	2	3	4	6		11	7	3	2														

-Asgjë nuk është konstante, përveç ndryshimit .

-Nuk ka zjarr të barabartë me pasionin , ose peshkajen me urrejtjen , as kurth me çmendurinë , ose përrua me lakminë .

- Çdo gjë vjen nga asgjëja dhe nga ky burim i
- përbashkët rrjedh detyra e vllazërisë
- dhe i mëshirës ndaj të gjitha krijesave
- -Ne jetojmë nga ajo që marrim, por e bëjmë jetën nga ajo që japim.

